



USHTRIA



Viti i 78-të i botimit Nr. 20 (827925)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 23 maj 2025

Ministri Vengu: Kolegji i Mbrojtjes, Shtyllë Themelore për Një Ushtri Moderne dhe të IntegrUAR



» faqe 3



MINISTRI VENGU: SHQIPËRIA KRAH KOSOVËS PËR GARANTIMIN E STABILITETIT NË RAJON

Ministri i Mbrojtjes z.Pirro Vengu dhe Shef i Shtabit të Përgjithshëm gjenerallejtënant Arben Kingji, pritën në një takim zyrtar komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Bashkim Jashari. Gjatë këtij takimi u diskutua mbi bashkëpunimin strategjik dhe vëllazëror ndërmjet dy vendeve...

» faqe 2



SHSHPPFA, GJENERALLEJTËNANT ARBEN KINGJI PRITI NË TAKIM ZYRTAR SHSHPPFA TË RUMANISË, GJENERAL GHEORGHITĂ VLAD

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjenerallejtënant Arben Kingji priti në një takim zyrtar shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Rumanisë, gjeneral Gheorghită Vlad. Ky takim thekson bashkëpunimin ekzistues në fushën e mbrojtjes midis Shqipërisë dhe Rumanisë, ku dy vendet kanë një histori bashkëpunimi të ngushtë...

»



“EUROPA FOLI SHQIP”

Intervistoi: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

“Europa foli shqip”, nuk është vetëm një metaforë, por një realitet i prekshëm gjatë samitit të Bashkimit Evropian me vendet e Ballkanit Perëndimor, i mbajtur, më 16 maj 2025, në Tiranë, i cili përfaqësoi një moment kyç në përpjekjet për integrimin e rajonit në BE dhe përf forcimin e stabilitetit gjeostrategjik në Evropën Juglindore. Samiti solli përfitime të shumta për Shqipërinë. Përveç rritjes së profilin ndërkombëtar, u theksua mbështetja e BE-së për zhvillimin ekonomik të vendit...

» faqe 5

Ministri Vengu: Shqipëria krah Kosovës për garantimin e stabilitetit në rajon

Ministri i Mbrojtjes z.Pirro Vengu dhe Shef i Shtabit të Përgjithshëm gjenerallejtënant Arben Kingji, pritën në një takim zyrtar komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Bashkim Jashari. Gjatë këtij takimi u diskutua mbi bashkëpunimin strategjik dhe vëllazëror ndërmjet dy vendeve tona në fushën e Mbrojtjes, i cili konsiderohet një faktor stabiliteti për rajonin dhe një orientim i qartë drejt integritimit euroatlantik.

Ministri Vengu vlerësoi nivelin e lartë të bashkëpunimit me Kosovën dhe konfirmoi përkushtimin e Ministrisë së Mbrojtjes për të mbështetur anëtarësimin e Kosovës në nisma rajonale dhe ndërkombëtare, përfshirë Kartën e Adriatikut (US-A5).

Ndër të tjera, në këtë takim u diskutua rreth situatës së brishtë të sigurisë në rajon, ku u dënuan sulmet terroriste dhe kriminale në veri të Kosovës, si dhe tensionet në Bosnje Hercegovinë. Ministri Vengu theksoi se Shqipëria do të mbetet gjithmonë krah Kosovës për të garantuar siguri dhe stabilitet të qëndrueshëm në rajon.

Po ashtu, ministri Vengu theksoi qëndrimin e Shqipërisë se misioni i NATO, KFOR, është garanti për sovranitetin dhe integritetin territorial të Kosovës.

Ministri Vengu dhe gjenerallejtënant Jashari theksuan prioritetet e përbashkëta për forcimin e FSK si një forcë moderne dhe territoriale përmes pesë shtyllave kryesore: kapitali njerëzor, modernizimi dhe zhvillimi i



kapaciteteve, industria ushtarake dhe inovacioni, qëndrueshmëria kombëtare (përfshirë mbrojtjen kibernetike dhe civile) dhe infrastruktura kritike.

Bashkëpunimi ndërmjet dy vendeve në fushën e Mbrojtjes është konkretizuar me pjesëmarrjen aktive në stërvitjen ndërkombëtare Defender Europe 2025, ku Shqipëria dhe Kosova luajnë një rol kyç.

Një tjetër fushë me rëndësi strategjike është ajo e arsimit ushtarak. Akademia e Forcave të Armatosura shqiptare vijon të ofrojë bursa dhe kurse për studentët dhe oficerët nga Kosova, ndërkohë që po shqyrtohen edhe kuota të veçanta në universitete publike për specialitete të rëndësishme për mbrojtjen.

U diskutua gjithashtu për mundësinë e

tërheqjes së burimeve njerëzore nga diaspora dhe individët me shtetësi të dyfishtë si dhe nxitjen e kthimit të profesionistëve me aftësi të larta në Shqipëri dhe Kosovë përmes stimujve konkretë. Plani i bashkëpunimit dypalësh për vitin 2025 përfshin 64 aktivitete konkrete: takime, trajnime, shkëmbim informacioni dhe stërvitje, të cilat janë tashmë në proces zbatimi.

Njësisia Ushtarake e Sigurisë Kibernetike (NJUSK) mori pjesë në stërvitjen e përvitshme ndërkombëtare “Cyber Yankee 2025”, e cila u zhvillua në Qendrën e Trajnimit “Edward Cross” në New Hampshire, SHBA.

Kjo stërvitje u organizua nga Gardat Kombëtare të shteteve të New England dhe New Jersey në kuadër të Programit të Partneritetit Shtetëror.

“Cyber Yankee” është një ndër stërvitjet më të rëndësishme në nivel taktik për operacionet e mbrojtjes kibernetike në SHBA. Ajo synon testimin e aftësive të reagimit ndaj incidenteve që prekin infrastrukturën kritike – përfshirë energjinë, gazin dhe furnizimin me ujë – përmes një bashkëpunimi të ngushtë ndërmjet forcave të armatosura, agjencive qeveritare, sektorit privat dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Në edicionin e njëmbëdhjetë të stërvitjes morën pjesë mbi 300 pjesëmarrës, përfshirë anëtarë të gardave kombëtare të ushtrisë, forcave ajrore, marinës dhe forcave hapësinore të SHBA-së. Po ashtu, pjesëmarrës ishin edhe ekspertë nga Komanda Kibernetike e SHBA-së, Agjencia për Sigurinë Kibernetike dhe Infrastrukturën (CISA), Departamenti i Energjisë dhe agjenci të tjera federale dhe shtetërore.

Shqipëria ishte një nga gjashtë partnerët ndërkombëtarë të ftuar në stërvitje, së bashku me Bahamas, El Salvador, Izraelin, Kenian dhe Paraguajin. Ekipi shqiptar demonstroi profesionalizëm të lartë në reagimin ndaj incidenteve, analizën e kërcënimeve dhe zbatimin e operacioneve mbrojtëse në mjedisin digjital.

Gjatë zhvillimit të kësaj stërvitjeje, anëtarët e ekipit Shqiptar morën gjithashtu pjesë në garat “Capture the Flag” (CTF), të organizuara nga Instituti Ndërkombëtar SANS. Këto gara janë sfida të avancuara në fushën e sigurisë kibernetike, ku pjesëmarrësit testojnë aftësitë e tyre në identifikimin dhe shfrytëzimin e cenueshmërive në sisteme të simuluar. Në një konkurrencë me mbi 300 pjesëmarrës,

Shqipëria, pjesë e stërvitjes ndërkombëtare kibernetike “Cyber Yankee 2025”



pjesëtarët e ekipit shqiptar arritën një sukses të jashtëzakonshëm duke zënë 4 vendet e para, duke dëshmuar jo vetëm nivelin e tyre të lartë teknik, por edhe përgatitjen dhe profesionalizmin e Njësisë Ushtarake të Sigurisë Kibernetike. Kjo pjesëmarrje përfaqëson një moment të rëndësishëm për forcimin e

kapaciteteve kombëtare të sigurisë kibernetike dhe shkëmbimin e përvojave me partnerë ndërkombëtarë. Duke marrë parasysh rritjen e kërcënimeve në fushën digjitale, bashkëpunime të tilla janë thelbësore për të ndërtuar një qasje të koordinuar dhe efektive ndaj sfidave të reja globale në sigurinë kibernetike.



Medalje e bronz të për ekipin snajperist të FARSH-së

Operatorët e Forcave Speciale të ROS u renditën në vendin e tretë në garën prestigjioze “Best Sniper Team Competition” në Turqi, mes 26 ekipeve nga 18 vende.

Një arritje që dëshmon profesionalizmin dhe përgatitjen elitare të Forcave tona të Armatosura.





Ministri Vengu: Kolegji i Mbrojtjes, Shtyllë Themelore për Një Ushtri Moderne dhe të IntegrUAR

Në ambientet e auditoriumit “Gjeneral Enrico Tellini” pranë Ministrisë së Mbrojtjes, u zhvillua ceremonia e certifikimit të pjesëmarrësve të Kursit të Lartë të 15-të për Sigurinë dhe Mbrojtjen, organizuar nga Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë.

Të pranishëm në këtë aktivitet ishin Ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu; Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjenerallejtant Arben Kingji; Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Mbrojtjes, z. Aleks Marku; përfaqësues të trupit diplomatik, atashe ushtarakë, përfaqësues të institucioneve shtetërore, drejtues të lartë të FA-së si dhe familjarë të pjesëmarrësve.

Në fjalën e tij përshëndetëse, komandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, gjeneral brigade Ylli Pulaj, theksoi rëndësinë e këtij kursi si platformë bashkëpunimi ndërkombëtar, ku këtë vit morën pjesë përfaqësues nga Kroacia, Gjeorgjia, Hungaria (për herë të parë), Italia, Kosova dhe Turqia. Ai vlerësoi gjithashtu kontributin e pjesëmarrësve shqiptarë dhe të vendeve partnere, që për tre muaj ndanë përvoja dhe ide në funksion të forcimit të një mjedisi të përbashkët sigurie.

Në emër të kursantëve foli kolonel Josef Veres, i cili falënderoi institucionet shqiptare për organizimin e një programi me standarde të larta profesionale dhe për përfshirjen e komponentëve ndërkombëtarë, që e bënë kursin gjithëpërfshirës dhe të pasur në përmbajtje.

Ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, përgëzoi pjesëmarrësit për përfundimin me sukses të këtij kursi dhe theksoi se Kolegji



i Mbrojtjes dhe Sigurisë përbën një nga shtyllat kryesore të vizionit për një forcë të armatosur moderne, të integruar dhe të aftë për të përballuar sfidat e sigurisë. Ai nënvizoi



gjithashtu angazhimin e Ministrisë në thellimin e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë dhe veçanërisht iniciativën për bashkëpunim me Kolegjin Evropian të Mbrojtjes dhe Sigurisë



Ceremonia u përmbyll me shpërndarjen e certifikatave për pjesëmarrësit, në vlerësim të përkushtimit dhe arritjeve të tyre gjatë programit.



Kontingjenti VIII i FD-së, niset në misionin e NATO-s “Aegean Sea”

Zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneral brigade Altin Kurti mori pjesë në ceremoninë e përcjelljes së Kontingjentit VIII të Forcës Detare, në misionin e NATO “Aegean Sea”, në detin Egje. Në këtë ceremoni ishin të pranishëm gjithashtu, komandanti i Forcës Detare, nënadmiralet Adnand Agastra, komandanti i Forcës Ajrore, gjeneralmajor Ferdinand Dimo, komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj, drejtorë drejtorish në SHP, familjarë e të ftuar. Gjeneral brigade Kurti në përshëndetjen e tij drejtuar trupave, e konsideroi këtë ditë një ditë të veçantë dhe moment krenarie e përgjegjësie. “Që nga dita kur ju u betuat për t’i shërbyer atdheut, Forcës Detare, u bëtë pjesë e diçkaje më të madhe se vetja dhe tani, ndërsa përgatiteni për të nisur këtë mision, ju mbani peshën e plotë të atij premtimi. Secili prej jush është stërvitur për këtë moment, secili prej jush mban peshën e betimit, ekuipazhit dhe vendit tuaj”, - u shpreh ndër të tjera gjeneral brigade Kurti.

Gjeneral brigade Kurti adresoi një falënderim



të veçantë edhe në emër të ministrit të Mbrojtjes z. Pirro Vengu dhe shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjenerallejtant Arben Kingji, ku vlerësojnë maksimalisht pjesëmarrjen dhe angazhimin e trupave në këtë mision. Duke përfunduar, gjeneral brigade Kurti, pasi iu uroi kthim të sigurt, det të qetë dhe erëra të mbara, u shpreh se: “Mbani mend kush jeni, mbani mend

se kë përfaqësoni dhe mbani mend se sado larg të lundroni, forca e plotë e vendit lundron me ju. Kryejeni misionin tuaj me nder dhe kthehuni duke ditur se keni bërë atë që pak kush mund ta bëjë...”.

Kontingjenti VIII i Forcës Detare është përshëndetur dhe nga komandanti i Forcës Detare, nënadmiralet Adnand Agastra, i cili pasi vlerësoi profesionalizmin e efektivëve theksoi se FD-ja po transformohet për të përmirësuar operacionet dhe ndërveprueshmërinë me vendet partnere të Aleancës. “Përveç pjesëmarrjes në operacionet e “Sea Guardian”, “FOCOPS”, ne po përgatitemi të zgjerojmë angazhimin tonë në rajonin e Detit të Zi dhe të ASPIDES, opsion i BE-së në Detin e Kuq, duke demonstruar përkushtimin tonë për të shërbyer si një partner i besueshëm në arkitekturën globale të sigurisë”. Ceremonia u përmbyll me dorëzimin e flamurit kombëtar nga komandanti i Forcës Detare nënadmiralet Agastra, komandantit të Kontingjentit VIII të misionit “Aegean Sea”, kapitenit të rangut III, Elton Kasemi.





Ministri Vengu: Modernizojmë FA-të me radar të lëvizshëm për vëzhgimin ajror

Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu priti në një takim zyrtar homologun e tij francez Sébastien Lecornu, në të parën vizitë të një ministri të Forcave të Armatosura të Francës në vendin tonë. Pas pritjes me truporë nderi, dy ministrat zhvilluan një takim tête-à-tête dhe më pas, bashkë me delegacionet që i shoqëronin, zhvilluan një takim ku në fokus të diskutimeve ishin modernizimi dhe zhvillimi i kapaciteteve të mbrojtjes, industria ushtarake, si dhe trajnimi e edukimi. Marrëveshjen teknike për modernizimin e Forcës sonë Ajrore me kapacitete të avancuara mobile të vëzhgimit ajror, ministri Vengu e konsideroi si tregues të qartë të një investimi strategjik për nevojat kombëtare dhe në funksion të Aleancës. Nga ana e tij, ministri i Forcave të Armatosura të Francës Sébastien Lecornu, e cilësoi marrëveshjen e nënshkruar si shumë të rëndësishme jo vetëm për rritjen e kapaciteteve të Forcës Ajrore shqiptare, por edhe për rritjen e ndërveprueshmërisë mes forcave aleate. Vizita zyrtare e ministrit të Forcave të Armatosura të Francës në vendin tonë zhvillohet edhe në kuadër të Samitit të Komunitetit Politik Evropian të mbajtur sot në Tiranë.



Kontingjenti XVII EOD u nis në misionin e radhës në Riga, Letoni

Në Batalionin e Xhenios u zhvillua ceremonia e nisjes së Kontingjentit XVII EOD, i cili do të marrë pjesë në misionin ndërkombëtar në përbërje të Brigadës Shumëkombëshe Letoneze (MNB-LVA), në kuadër të Forcës së Përparuar Tokësore (Forward Land Forces – FLF), në Riga, Letoni. Në këtë ceremoni morën pjesë Drejtori i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Ardian Lilo, Zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse, kolonel Shkëlqim Çela, komandantë të reparteve, si dhe familjarë të pjesëtarëve të kontingjentit. 21 ushtarake shqiptarë do të përfaqësojnë me profesionalizëm dhe përkushtim Forcat e Armatosura të Shqipërisë, duke shërbyer krah aleatëve të NATO-s dhe duke dëshmuar me krenari se paqja dhe siguria janë misioni ynë i përbashkët.



SHSHPFA, gjenerallejtënant Arben Kingji priti në takim zyrtar SHSHPFA të Rumanisë, gjeneral Gheorghiță Vlad

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjenerallejtënant Arben Kingji priti në një takim zyrtar shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Rumanisë, gjeneral Gheorghiță Vlad. Ky takim thekson bashkëpunimin ekzistues në fushën e mbrojtjes midis Shqipërisë dhe Rumanisë, ku dy vendet kanë një histori bashkëpunimi të ngushtë dhe të hershme. Rumania është nga vendet që e ka mbështetur anëtarësimin e Shqipërisë në NATO dhe vijon mbështetjen edhe për anëtarësimin në BE.

Fushat e bashkëpunimit ndërmjet dy forcave të Armatosura konsistojnë në aktivitete të përbashkëta, stërvitje dhe trajnime, si dhe bashkëpunim në iniciativa rajonale si Forumi i Shefave të Shtabeve të Përgjithshëm të Vendeve të Ballkanit (BCHODs), Nisma e Ministrave të Mbrojtjes së Europës Juglindore (SEDM), si dhe Brigada e Europës Juglindore (SEEBRIG) ku Shqipëria aktualisht mban postin e komandantit.

Në kontekst të gjerë u diskutua edhe mbi sfidat aktuale të sigurisë, me fokus të veçantë situatën në Ballkanin Perëndimor. Këto sfida e bëjnë bashkëpunimin midis vendeve aleate akoma më të rëndësishëm.

Në këtë kuadër, u vlerësua si i domosdoshëm dhe i rëndësishëm kontributi i të dy vendeve me trupa në misionin e NATO-s në Kosovë (KFOR) dhe në operacionin e Bashkimit Evropian në Bosnje dhe Hercegovinë (ALTHEA), në funksion të stabilitetit dhe sigurisë rajonale.

Takimi midis dy Shefave të Shtabeve të Përgjithshëm është një sinjal i fortë i vullnetit të të dy vendeve për të forcuar bashkëpunimin e tyre në fushën e mbrojtjes, duke kontribuar në stabilitetin dhe sigurinë e rajonit.



Nënoficerët e Detashmentit të dronëve UAV përfundojnë “Basic Leader Course (BLC) NCO”, në Akademinë e Ushtrisë Amerikane në Grafenwörf, Gjermani

Për një periudhë njëmuajore, për herë të parë, tre nënoficerë të Detashmentit të dronëve UAV, të Forcës Ajrore, morën pjesë në trajnimin “Basic Leader Course (BLC) NCO”, zhvilluar në Akademinë e Ushtrisë Amerikane në Grafenwörf, Gjermani.

Tre nënoficerët e Detashmentit UAV: nëntetare Kamila Toslluku, nëntetare Eduart Barjami dhe nëntetare Fatjon Pirja, në përfundim të trajnimit u vlerësuan nga instruktorët amerikanë për profesionalizmin dhe përkushtimin e treguar gjatë gjithë periudhës së trajnimit. Nga ana e tyre u theksua rëndësia e këtij trajnimi, si një model për integrimin e suksesshëm të kapaciteteve ushtarake në kuadër të standardeve të NATO-s.

Ky trajnim, është projektuar për të zhvilluar aftësitë thelbësore të lidërshit tek nënoficerët e rinj dhe për t'i përgatitur ata për përgjegjësi më të mëdha në strukturat ushtarake. Përgjatë këtij trajnimi, nënoficerët realizuan udhëheqje të njëjësive, planifikim operativ, procedura luftarake, menaxhim trajnimi dhe testime të performancës fizike, sipas standardeve të ushtrisë së SHBA-ve.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

“Europa foli shqip”, nuk është vetëm një metaforë, por një realitet i prekshëm gjatë samitit të Bashkimit Evropian me vendet e Ballkanit Perëndimor, i mbajtur, më 16 maj 2025, në Tiranë, i cili përfaqësoi një moment kyç në përpjekjet për integrimin e rajonit në BE dhe përfundimin e stabilitetit gjeostrategjik në Evropën Juglindore.

Përfitimet politike dhe ekonomike

Samiti solli përfitime të shumta për Shqipërinë. Përveç rritjes së profilit ndërkombëtar, u theksua mbështetja e BE-së për zhvillimin ekonomik të vendit. Presidentja e Komisionit European, Ursula von der Leyen, njoftoi plane për të dyfishuar ekonominë e Ballkanit Perëndimor përmes mbështetjes financiare për projekte infrastrukturore të mëdha.

Sfida dhe perspektiva

Pavarësisht suksesit të samitit, sfidat për integrimin e plotë të Shqipërisë në BE mbeten. Hendeku zhvillimor midis vendeve të Ballkanit dhe mesatares së BE-së, si dhe emigracioni i lartë, janë çështje që kërkojnë zgjidhje afatgjata. Analizat sugjerojnë se trajtimi i Ballkanit Perëndimor si pjesë e BE-së është një mënyrë efektive për të zbutur këto sfida. Samiti i BE-së në Tiranë shënoi një hap të rëndësishëm drejt integritetit të Shqipërisë në Bashkimin European. Përmes këtij eventi, Europa jo vetëm që foli shqip, por edhe dëshmoi angazhimin e saj për të qenë më pranë vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ky samit përforcoi besimin se Shqipëria është në rrugën e duhur drejt anëtarësimit në BE, duke u bërë një pjesë e pandashme e familjes evropiane.

Simbolika dhe mesazhi i samitit

Samiti në Tiranë përforcoi rolin e Shqipërisë si një partner i rëndësishëm në skenën evropiane dhe dëshmoi angazhimin e vendit për integrimin evropian. Pjesëmarrja e gjerë e liderëve evropianë dhe diskutimet mbi çështje kyçe si siguria, ekonomia dhe të rinjtë, treguan përkushtimin e përbashkët për një Evropë më të bashkuar dhe më të fortë.

Samiti i Komunitetit Politik Evropian (KPE), solli disa përfitime të rëndësishme për Shqipërinë, si në aspektin politik, gjeostrategjik, ashtu edhe në imazh ndërkombëtar si:

Rritje e profilit ndërkombëtar të Shqipërisë

Shqipëria u vendos në qendër të vëmendjes evropiane si mikpritëse e një samiti me rëndësi strategjike për të gjithë kontinentin.

Tiranës iu besua roli i organizatores së një takimi me mbi 45 liderë shtetesh, duke e kthyer në një epiqendër diplomatike të Evropës.

Forcim i marrëdhënieve me BE-në dhe vendet e tjera evropiane

Samiti shërbeu si platformë për takime dypalëshe të kryeministrit Edi Rama me liderë kyç të BE-së si Ursula von der Leyen, Emmanuel Macron, Olaf Scholz etj. U thelluan marrëdhëniet strategjike me shtete si Franca, Gjermania, Mbretëria e Bashkuar, Turqia, Italia, etj.

Mbështetje për projekte konkrete

U diskutua për mbështetje konkrete ekonomike dhe projekte në infrastrukturë, energji dhe digjitalizim në Ballkanin Perëndimor. Shqipëria përfitoi nga paketa e mbështetjes ekonomike që BE po ofron për rajonin, pjesë e Planit të Rritjes prej 6 miliardë eurosh.

Mesazhi i fortë për integrimin në BE

Të gjithë liderët evropianë theksuan qartë se e ardhmja e Shqipërisë është në BE, duke riafirmuar angazhimin e tyre për zgjerimin e saj. Samiti përforcoi idenë se Shqipëria nuk është më thjesht një vend kandidat, por një aktor politik dhe gjeostrategjik i vlefshëm për Evropën.

Përfshirje në diskutimet për sigurinë dhe paqen

Shqipëria mori pjesë aktive në diskutimet mbi sigurinë evropiane, agresionin rus në Ukrainë dhe sfidat në Lindjen

“Europa foli shqip”



e Mesme, duke treguar se ka rol aktiv në politikën e jashtme evropiane.

Fitore për imazhin kombëtar

Mediat evropiane raportuan pozitivisht për organizimin e samitit, ndërsa liderët e BE-së e vlerësuan Shqipërinë si mikpritëse të denjë dhe me kapacitete moderne. Kjo i dha vendit një shtysë të madhe në aspektin e PR-it ndërkombëtar dhe promovimit të turizmit e investimeve.

Samiti i Tiranës shënoi një përpjekje të përbashkët për të integruar më ngushtë Ballkanin Perëndimor në strukturat evropiane, duke e konsideruar zgjerimin e BE-së si një investim strategjik për sigurinë dhe stabilitetin e kontinentit.

Në kontekstin e sfidave aktuale, si agresioni rus në Ukrainë dhe ndikimi i aktorëve të tjerë globalë në rajon, përfshirja e Ballkanit Perëndimor në BE shihet si një masë për të forcuar kohezionin dhe për të parandaluar ndikime të jashtme destabilizuese.

Roli i Shqipërisë

Si vend mikpritës, Shqipëria demonstroi angazhimin e saj për integrimin evropian dhe rolin e saj si një partner i besueshëm në rajon.

Në Samitin e 16 majit 2025, në Tiranë, Shqipëria u vlerësua pozitivisht nga liderët evropianë dhe rajonalë, si një vend mikpritës dhe një partner i rëndësishëm në Ballkanin Perëndimor.

Vlerësimet nga liderët e Bashkimit Evropian

Ursula von der Leyen (Presidentja e Komisionit Evropian): E quajti Shqipërinë një mikpritëse shembullore. Vlerësoi progresin e Shqipërisë në reformat për integrimin në BE. Shprehu mbështetjen për përsheptimin e negociatave të anëtarësimit.

Charles Michel (President i Këshillit Evropian): Theksoi rolin e Shqipërisë si një faktor stabiliteti në rajon. Përmendi përparimin në përputhjen me politikën e

jashtme dhe të sigurisë së BE-së, sidomos për vendosjen e sanksioneve ndaj Rusisë.

Vjosa Osmani (Presidente e Kosovës): E vlerësoi Shqipërinë si një mbështetëse të fortë të rrugës evropiane të Kosovës.

Znj. Osmani, theksoi se mikpritja shqiptare tregoi se Ballkani është i gatshëm të jetë pjesë e Evropës.

Perceptimi politik dhe gjeostrategjik

Shqipëria u pozicionua si një urë ndërlidhëse mes vendeve të rajonit dhe Bashkimit Evropian.

U vlerësua për përkushtimin ndaj vlerave demokratike dhe rolit aktiv në luftën kundër dezinformimit dhe ndikimeve të jashtme (sidomos ruse dhe kineze).

Ishte e dukshme që Tirana u konsiderua si një qendër e rëndësishme strategjike dhe diplomatike për BE-në në rajon.

Impresionet mbi organizimin e samitit

Samiti u organizua në mënyrë profesionale dhe me standarde të larta, çka u përmend nga shumë liderë si dëshmi e kapaciteteve të Shqipërisë për të menaxhuar evente të rëndësishme ndërkombëtare.

Shqipëria u vlerësua si: Një partnere e besueshme për BE-në.

Një aktor stabilizues në Ballkanin Perëndimor. Një model pozitiv për fqinjët në zbatimin e reformave dhe në angazhimin për vlerat evropiane.

Në këtë mënyrë, roli i Shqipërisë në këtë samit shënoi një rritje të profilit të saj ndërkombëtar dhe e forcoi më tej pozicionin e saj si një vend lider në rajon për integrimin në Bashkimin Evropian.

Samiti i majit 2025 në Tiranë nuk ishte vetëm një aktivitet formal diplomatik, por një momenti historik që e konsolidoi Shqipërinë si pjesë aktive të familjes politike evropiane dhe e afrooi edhe më shumë me integrimin e plotë në Bashkimin Evropian.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s merr pjesë në takimin e Komunitetit Politik Evropian

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, iu bashkua udhëheqësve evropianë në një takim të Komunitetit Politik Evropian në Tiranë, Shqipëri, për të diskutuar shqetësimet e përbashkëta të sigurisë.

Ndër angazhime të tjera, z. Rutte u takua me Presidenten e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen dhe mori pjesë në një takim dypalësh me Kryeministrin e Shqipërisë Edi Rama, në të cilin diskutuan situatën në Ballkanin Perëndimor. Sekretari i Përgjithshëm gjithashtu mori pjesë në një tryezë të rrumbullakët mbi rritjen e konkurrueshmërisë dhe sigurisë evropiane përmes inovacionit dhe qëndrueshmërisë.

Lufta kundër Ukrainës mbeti në qendër të vëmendjes së udhëheqësve, me Sekretarin e Përgjithshëm që ripërtëriu thirrjet që Rusia të angazhohet në mënyrë kuptimplote në bisedimet e paqes. “Ai duhet të jetë serioz në lidhje me dëshirën për paqe. Mendoj se i gjithë presioni tani është mbi Putinin”, tha z. Rutte, duke përgëzuar ukrainasit për pjesëmarrjen në diskutime me një delegacion të gatshëm për të negociuar një armëpushim.



Sekretari i Përgjithshëm bën thirrje për bashkëpunim më të fortë NATO-BE për të forcuar parandalimin dhe mbrojtjen

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, mori pjesë në Këshillin e Punëve të Jashtme me Ministrat e Mbrojtjes të BE-së. Ai theksoi rëndësinë e marrëdhënieve më të ngushta NATO-BE, në dritën e kërcënimeve nga Rusia, përforcimi ushtarak i Kinës dhe terrorizmi.

Z. Rutte nënvizoi nevojën për të rritur shpenzimet dhe prodhimin e mbrojtjes, dhe “për t’u siguruar që Ukraina të ketë atë që i nevojitet për ta çuar këtë luftë në një fund të qëndrueshëm dhe të qëndrueshëm”.

Ministrat e Jashtëm të NATO-s takohen për të përgatitur Samitin në Hagë

Ministrat e Jashtëm të NATO-s u takuan në Antalia, Turqi, për të diskutuar forcimin e parandalimit dhe mbrojtjes së Aleatëve, si dhe për të çuar përpara përgatitjet për Samitin në Hagë në qershor.

Sekretari i Përgjithshëm e bëri të qartë se përcaktimi i një shifre të re bazë të shpenzimeve do të ishte rezultati kryesor i Samitit, duke theksuar se objektivi ekzistues prej 2% “nuk është as afër mjaftueshëm”.

“Do të na duhen investime më të mëdha në kërkesat tona kryesore ushtarake, si dhe investime shtesë më të gjera në lidhje me mbrojtjen, duke përfshirë infrastrukturën dhe qëndrueshmërinë”, tha Sekretari i Përgjithshëm, duke theksuar se kjo kishte kuptim si ekonomik ashtu edhe strategjik. “Duhet të sigurohemi që të shpenzojmë mjaftueshëm para në të gjithë NATO-n për të mbajtur veten të sigurt”, - vazhdoi ai, duke këmbëngulur se ndryshimet do të ishin thelbësore për

përmbushjen e objektivave të rinj të aftësive të NATO-s dhe për të penguar agresionin.

Z. Rutte vlerësoi anëtarët e NATO-s për demonstrimin e angazhimit të tyre në rritje për ndarjen e drejtë të barrës, duke pohuar se “tani jemi në rrugën e duhur”. “Shumica e aleatëve tani janë gati të arrijnë qëllimin fillestar të shpenzimit të 2% të PBB-së për mbrojtje këtë vit dhe shumë prej tyre kanë njoftuar tashmë plane për të shkuar shumë më tej”, - shtoi ai.

Sekretari i Përgjithshëm gjithashtu riafirmoi mbështetjen afatgjatë të NATO-s për Ukrainën, duke theksuar përpjekjet për ta çuar luftën në një fund të drejtë dhe të qëndrueshëm si një përparësi e përbashkët për të gjithë aleatët. “Me ose pa një zgjidhje, është e qartë se mbështetja jonë për Ukrainën do të vazhdojë të jetë e rëndësishme për të siguruar një paqe të qëndrueshme”, - përfundoi ai.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Castet nga jeta na bëjnë të reflektojmë mbi atë që sjell e ardhmja dhe mbi transformimin e perceptimit të gjithkujt. Kjo ndikon dhe tek qasja jonë ndaj atyre që 'investojnë' tek ne për të ndryshuar.

Kur isha fëmijë, më thanë: "Kurrë mos ia jep hua çadrën dikujt që të kujton vetëm kur bie shi". Nuk e kuptoja në atë kohë. Thjesht mendova se ishte një fjali e bukur, asgjë tjetër. Por unë u rrita dhe jeta më mësoi kuptimin e saj.

Mësova se ka njerëz që shfaqen vetëm kur u duhet diçka, që të kërkojnë kur bota e tyre shembet, por kur dielli shkëlqen, as emrin tënd nuk e mbajnë mend. Tani kur dikush afrohet nën stuhi, pyes veten nëse nesër, kur të dalë dielli, a do të vazhdoj të ekzistoj për të?! Kurrë mos ia jep hua çadrën dikujt që të kujton vetëm kur bie shi".

Në jetën tonë të përditshme, shpesh përballemi me njerëz që vijnë e shkojnë, ashtu si stinët. Disa qëndrojnë edhe kur dielli shkëlqen lart në qiell, të tjerë shfaqen papritur, si retë e zeza që sjellin shiun.

Vlera jonë nuk duhet të matet nga sa shumë japim, por nga kujt ia japim. Është e lehtë të jesh "mik i shiut", – të kujtohesh për dikë vetëm kur ke nevojë për të, vetëm kur ke humbur rrugën, kur të mungon ngrohtësia që dikur e refuzove. Por miqësitë e vërteta, lidhjet e thella shpirtërore, provohen në diell dhe në shi njësoj.

Nuk duhen kërkuar kur të mungojnë mundësitë, por duhet të ushqehen vazhdimisht, me përkujdesje dhe ndjeshmëri.

Të mos ia japësh hua çadrën dikujt që të kujton vetëm kur bie shi, nuk është akt egoizmi, por vetëmbrojtje. Është një mënyrë për të vendosur kufij të shëndetshëm në jetën tënde, për të mbrojtur energjinë tënde nga ata që nuk dinë ta vlerësojnë. Kjo është rritje e vetëdijes, për ata që kemi rreth nesh – për ata që janë aty edhe kur nuk kanë asgjë për të kërkuar, për ata që nuk harrojnë të të thonë "si je?" edhe kur gjithçka shkon mirë. Jeta është e shkurtër për t'u shpenzuar në marrëdhënie që nuk kanë thellësi. Mos i jep gjithmonë çadrën atij që të kujton vetëm kur bie shi. Sepse ndoshta kur të vijë shiu yt, ai nuk do të jetë askund. Zgjidh t'i japësh çadrën tënde dikujt që do të rrijë pranë edhe pa pasur nevojë për të, dikujt që të sjell diell në ditët më gri, dikujt që të kujton edhe kur qielli është i kthjellët.

Në fund të fundit, ndihmo, ofro, jep nga vetja – por kurrë mos lejo që të të përdorin. Sepse dashuria dhe mirësia e singertë nuk janë hua, janë dhurata që duhet të japin e marrin me zemër.

Çadra ime nuk është më hua

Në një ditë me shi, kur qielli kishte harruar se si dukej ngjyra blu, era përplaste gjethet në trotuar, si të donte të fshinte kujtimet që koha kishte lënë pas. Në dorë mbaja çadrën time të vjetër, atë që më kishte mbrojtur në qindra stuhi, u ndala te stacioni, dhe ashtu si gjithmonë, shikimi më ndaloi tek ajo figurë e njohur – ajo që më kujtohej vetëm kur binte shi. Erdhi me të njëjtin buzëqeshje që e kam parë dhjetëra herë, të ngjashme me një përqafim që nuk ngroh, por thjesht fsheh boshllëkun. "E ke një çadër të lirë?" – më pyeti, si gjithmonë. Dhe unë, me atë zemër që gjithmonë pëlqente të ishte strehë për të tjerët, ia dhashë. Edhe këtë herë. Si çdo herë. Ajo iku. As nuk ktheu kokën.

Qëndrova vetëm, nën shi, pa strehë. Jo vetëm fizikisht, por edhe shpirtërisht. Sepse kuptova diçka që më kishte ikur për vite të tëra: disa njerëz të kujtohen vetëm kur janë të lagur, kur kanë ftohtë, kur rruga u duket e gjatë. Pastaj, kur ngrohen, të harrojnë. Të lënë aty ku të gjetën – nën reshjet që vetëm ti i ndjen deri në palcë.

Ajo çadër s' më është kthyer më, ashtu si 'copëzat' e mija pa i marrë kurrë mbrapsht. Ashtu si të gjitha ditët kur dikush u strehua në mirësinë time, dhe më la zbuluar përballë motit të keq.

Që atë ditë, vendosa: çadra ime nuk është më hua. Nuk është më për ata që më kërkojnë vetëm kur bien shirat. Ajo

Kurrë mos ia jep hua çadrën dikujt që të kujton vetëm kur bie shi



është për ata që qëndrojnë me mua edhe kur nuk kanë nevojë për strehë, për ata që nuk largohen sapo dielli të dalë përsëri. Nuk ka kuptim të jesh strehë për dikë që s'të njeh, veç kur rruga e tij përmbytet. Dhe çadrat? Ato nuk janë vetëm për shiun. Janë për kujtimet. Për të gjithë ata që kanë dhënë shumë, dhe kanë mbetur pa çadër.

Ka njerëz që janë si shtëpi të hapura, dera e tyre nuk ka çelës, zemra e tyre nuk njeh prag. Janë ata që japin gjithçka pa llogari: kohë, fjalë të mira, ngrohtësi, përqafime, përkrahje. Japin veten, copa nga shpirti i tyre, herë pas here edhe kur askush nuk ua kërkon. E bëjnë, sepse ashtu janë ndërtuar, prej dhembshurie, jo prej dyshimi. Prej dritës, jo prej hijeve. Këta njerëz janë çadrat e botës. Janë strehët në ditët me stuhi, janë zëri që të thotë "jam këtu" kur gjithçka tjetër hesht. Ata nuk pyesin pse bie shi, thjesht e hapin çadrën e tyre dhe të futin brenda. Të mbrojnë. Të ngrohin. Të japin gjithçka, edhe kur vetë janë të lagur deri në palcë. Bota nuk është gjithmonë e drejtë me ta.

Në një botë ku gjithçka matet me interes, ndjeshmëria është një akt rebelimi

Të japësh pa kërkuar është një formë dashurie që pak e njohin dhe më pak e vlerësojnë. Në realitetin e sotëm, ku marrëdhëniet shpesh ndërtohen mbi përfitimin dhe çdo veprim shihet përmes një filtri interesash personale, ndjeshmëria duket si një anomali.

Jetojmë në një kohë kur empatia, dhembshuria apo mirësia pa interes, shpesh keqkuptohen si dobësi.

Por pikërisht në këtë kontekst të ftohtë dhe racional,

ndjeshmëria bëhet një akt rebelimi, një formë rezistence ndaj një bote që ngurtësohet çdo ditë më shumë.

Ndjeshmëria nuk është vetëm aftësia për të ndjerë dhimbjen apo gëzimin e tjetrit, por është zgjedhja për t'u ndalur, për të dëgjuar, për të qenë i pranishëm emocionalisht në një botë që nxit indiferencën.

Është kundër-kulturë në një shoqëri që vlerëson garën para solidaritetit, përfitimin para ndihmës, dhe imazhin para autenticitetit.

Në një realitet ku gjithçka ka një çmim, të tregosh ndjeshmëri pa pritur asgjë në kthim është të sfidosh normat. Është të tregosh se njeriu nuk është vetëm një hallkë në një mekanizëm ekonomik, por një qenie me zemër, emocione dhe lidhje të thella shpirtërore.

Ndjeshmëria është rebelim, sepse ajo kërkon guxim – guxim për të mos u mbyllur ndaj dhimbjes së tjetrit, për të pranuar brishtësinë si vlerë dhe jo si turp. Është akti i të jetuarit ndryshe, në një mënyrë më humane, më të ndjeshme, më të ndritshme. Dhe në këtë mënyrë, ndjeshmëria bëhet formë qëndrese, një protestë e heshtur ndaj ftohtësisë së një bote që ka harruar të ndjejë.

Ndjeshmëria nuk është vetëm një virtut moral, është një akt që ndryshon botën në mënyrën më të thellë dhe më të qëndrueshme, përmes zemrës.

Në një epokë ku gjithçka vlerësohet përmes leverdisë, të jesh i ndjeshëm është të kujtosh njerëzimit se ka ende vlera që nuk maten me interes, dhe ky është revolucion i bukuri, i inteligjencës artificiale - AI, ka dështuar plotësisht!

Nga Iliria në Ditët e Sotme: Evolucioni i Ushtrisë Shqiptare

Ushtria shqiptare ka një histori të gjatë dhe të ndërlikuar që reflekton zhvillimet politike, sociale dhe ushtarake të kombit shqiptar përmes shekujve. Kronologjia e gjurmëve të saj në kohë:

Kohët e lashta dhe mesjeta

Ilirët (para-erës sonë – shek. I): Ilirët, paraardhësit e shqiptarëve, kishin formacione të strukturuar ushtarake. Ata njiheshin si luftëtarë të fortë dhe shpesh përballeshin me perandoritë greke dhe romake. Mbretër si Agroni, Teuta dhe Genti, kishin flota detare dhe ushtri tokësore të organizuar.

Mesjeta: Gjatë mesjetës, shqiptarët luftuan për të ruajtur autonominë kundër perandorisë osmane.

Gjergj Kastrioti - Skënderbeu (1405–1468) formoi Ushtrinë Arbërore, një forcë e disiplinuar, që për 25 vite ndaloi përparimin osman në Evropë. Ai u bë simbol i rezistencës shqiptare dhe i luftës për liri.

Periudha Osmane (shek. XV–XX)

Nën sundimin osman, shqiptarët nuk kishin një ushtri kombëtare, por kontribuan në ushtrinë osmane si jeniçerë apo në forma të tjera.

U organizuan kryengritje të armatosura, veçanërisht në shek. XIX, me qëllim pavarësinë. Rëndësi të veçantë ka Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878), që kishte edhe një forcë të armatosur për mbrojtjen e tokave shqiptare.

Shekulli XX – Formimi i ushtrisë moderne shqiptare

1912 – Pavarësia: Pas shpalljes së Pavarësisë, më 28 nëntor 1912, Ismail Qemali filloi ndërtimin e një ushtrie kombëtare, por kjo u vështirësua për shkak të konflikteve ballkanike dhe ndërhyrjes së fuqive të huaja.

Mbretëria Shqiptare (1928–1939): Nën Mbretin Zog I, u modernizua ushtria, u krijuan struktura të reja dhe u ndërtuan akademi ushtarake.

Lufta e Dytë Botërore: Shqiptarët morën pjesë aktivisht në rezistencën antifashiste kundër pushtimit italian dhe më pas atij gjerman.

U formuan njësitë partizane, të cilat do të shndërroheshin në bazë për Ushtrinë Popullore Shqiptare pas vitit 1944.

Regjimi komunist (1945–1990): Ushtria ishte e ndërtuar mbi modelin sovjetik dhe më pas kinez.

Shqipëria u bë një nga vendet më të militarizuara për frymë në botë.

U ndërtuan mijëra bunkerë në të gjithë territorin si mbrojtje ndaj pushtimit të jashtëm.



Periudha pas komunizmit (1991 e tutje)

Pas rënies së komunizmit, ushtria kaloi në një proces të thellë reformimi dhe profesionalizimi.

Shqipëria hoqi dorë nga shërbimi i detyrueshëm ushtarak dhe krijoi një forcë të armatosur profesionale.

NATO dhe angazhimet ndërkombëtare: Shqipëria u anëtarësua në NATO më 2009.

Forcat e Armatosura Shqiptare kanë marrë pjesë në misione ndërkombëtare në Afganistan, Irak, Bosnje, Kosovë, Mali etj.

Muze ushtarake, memoriale dhe dokumente historike ruajnë kujtesën e përpjekjeve ushtarake shqiptare.

Figura si Skënderbeu, Isa Boletini, Azem Galica, dhe Adem Jashari janë pjesë e identitetit kombëtar dhe historisë ushtarake shqiptare.

Figura Historike

Gjergj Kastrioti – Skënderbeu (1405–1468), Komandant i Ushtrisë Arbërore. Luftoi për 25 vite kundër Perandorisë Osmane; u bë simbol i rezistencës shqiptare.

Arritje: Bashkoi principatat shqiptare dhe krijoi një ushtri të organizuar kombëtare.

Isa Boletini (1864–1916) - Udhëheqës ushtarak i Kosovës. Luftoi për mbrojtjen e tokave shqiptare në Vilajetin e Kosovës dhe për pavarësinë e Shqipërisë.

Fjalët e famshme: “Unë jam mirë kur asht mirë Shqipëria”.

Azem Galica (1889–1924) - Komandant i çetave të Drenicës. Luftoi kundër pushtimit serb në Kosovë pas shpërbërjes së Perandorisë Osmane.

Bajram Curri (1862–1925) - Strateg dhe luftëtar i çështjes kombëtare. Mori pjesë në Lidhjen e Pejës dhe Lëvizjet për Pavarësi; bashkëpunoi me Ismail Qemalin.

Ali Kelmendi (1900–1939) - Komunist dhe veteran i Luftës Civile në Spanjë. U trajnuar ushtarakisht jashtë vendit dhe solli përvojë luftarake në Shqipëri në prag të Luftës së Dytë Botërore.



Mehmet Shehu (1913–1981) - Komandant brigade, më pas Ministër i Mbrojtjes dhe Kryeministër. Luftëtar në Spanjë, më pas në udhëheqje të luftës antifashiste në Shqipëri.

Adem Jashari (1955–1998) - Themelues i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Hero i luftës për liri në Kosovë; ra dëshmor bashkë me familjen në Prekaz. Simbol i rezistencës së armatosur kundër Serbisë.

Zahir Pajaziti (1962–1997) - Një nga themeluesit e UÇK-së. Organizatë dhe strukturim i formacioneve të para të UÇK-së. Ra në aksion në vitin 1997.

Reformimi dhe profesionalizimi
Shërbimi i detyrueshëm ushtarak është hequr. FA përbëhet nga ushtarakë profesionistë.

Pajisje moderne, trajnime me vende aleate si SHBA, Turqia, Italia, Gjermania.

Fokus i madh, arsimimi ushtarak (në Akademinë e Forcave të Armatosura) dhe trajnimin ndërkombëtar.

Simbolika dhe përfaqësimi
Stema dhe flamuri i FA-ve, përmbajnë shqiponjën dykrenare dhe elemente tradicionale shqiptare.

Misioni i FA-së është: “Të mbrojë sovranitetin, pavarësinë, tërësinë territoriale dhe interesat kombëtare të Republikës së Shqipërisë”.

Struktura kryesore e Ushtrisë Shqiptare:
Komanda e Forcave të Armatosura (Shtabi i Përgjithshëm) –

Organizon dhe komandon të gjitha njësitë ushtarake.

Forca Tokësore – Përgjegjëse për operacionet në tokë. Ka njësi këmbësorie, logjistike dhe mbështetëse.

Forca Ajrore – Operon helikopterë transportues dhe për misione kërkim-shpëtimi. Shqipëria aktualisht nuk ka avionë luftarakë.

Forca Detare – Patrullon ujërat territoriale dhe angazhohet në operacione të sigurisë detare, si edhe kundër-trafikut.

Policia Ushtarake – Ruan rendin dhe sigurinë brenda FA-së.
Akademia e Forcave të Armatosura, si një prej institucioneve lider dhe unik në formësimin e kapaciteteve akademike ushtarake dhe institucionale me një traditë 67-vjeçare, ka hyrë tashmë në një transformim të qëndrueshëm për ta shndërruar atë, në njërin prej institucioneve të arsimit të lartë më me ndikim në fushën e sigurisë në vend.

Në funksion të arritjes së këtij objekti, AFA ka përqafuar vizionin për t’u kthyer në një qendër moderne të arsimit të lartë ushtarak dhe të kërkimit shkencor në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare. Ky transformim synon që ta kthejë këtë akademi në një “laborator” të formimit të gjeneratës së re të oficerit të ri, liderit të ardhshëm më të mirë në nivel kombëtar.

Forcat tona të Armatosura janë syri dhe siguria e qytetarëve të këtij vendi, janë forca që kanë më shumë besueshmëri në popull.

Ministria e Mbrojtjes, qeveria shqiptare i vlerëson FA-të si një trupë që përfaqëson edhe dinjitetin e Shqipërisë, përkrah aleatëve të NATO-s. Ndaj e ka vlerësuar dhe e vlerëson shumë të rëndësishme, rritjen e dinjitetit të çdo efektivit përmes një trajtimi më të mirë financiar, përmirësimit të kushteve të stërvitjes, kujdesit shëndetësor për ushtarakët dhe familjet e tyre, si dhe integrimin e tyre në shoqëri pas daljes në rezervë.

Një pikë e rëndësishme, për të cilën janë mjaft projekte që prej vitit të kaluar dhe do të vijojmë edhe në 2025, është



modernizimi i FA-ve. Kjo realizohet përmes pajisjes së Forcave të Armatosura me kapacitetet e nevojshme për t’u përballur me sfidat e ardhshme.



Figura nga Lufta e Dytë Botërore

Enver Hoxha (1908–1985) - Komandant Suprem i Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Drejtoi forcat partizane që çlijuan vendin nga pushtimi nazifashist. Më pas udhëhoqi Shqipërinë për dekada si diktator.



KOLONEL (R) ARBEN DHULI

“Ushtria marshon mbi stomakun e saj” – thotë Napolon Bonaparti, pasi ajo përfshin furnizimin me ushqim, karburant, municione, armatime dhe pajisje si dhe lëvizshmërinë dhe transportin e forcave, duke siguruar që njësitë ushtarake mund të veprojnë në kushte të ndryshme dhe gjatë periudhave të ndryshme kohore. Roli i logjistikës në çdo komb, por edhe në NATO është thelbësor për sigurimin e suksesit të operacioneve të aleancës, veçanërisht në kontekste ku mund të ketë mungesë mbështetjeje direkte nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA). NATO, si një aleancë ndërkombëtare e përbërë nga shtete anëtare me kapacitete dhe nevoja të ndryshme, përballlet me sfida të mëdha logjistike për të ruajtur qëndrueshmërinë operative dhe për të siguruar efikasitetin në misionet e saj. Varësia nga logjistika ushtarake e SHBA-ve, pasi ato janë një prej kontribuuesve kryesorë në logjistikën e NATO-s, duke ofruar kapacitete të mëdha transporti, mbështetje teknike dhe mjetet e nevojshme për operacione. Kur kjo mbështetje nuk është e disponueshme, NATO duhet të sigurojë që shtetet e tjera anëtare të kenë kapacitete të mjaftueshme për të mbajtur operacionet aktive. Kombinimi i kapaciteteve të ndryshme pasi shtetet anëtare të NATO-s kanë kapacitete të ndryshme logjistike, duke përfshirë teknologji, infrastrukturë dhe burime njerëzore. Sigurimi i një niveli të lartë koordinimi midis këtyre kapaciteteve është një sfidë, veçanërisht kur ka mungesë mbështetjeje të përbashkët ose të centralizuar.

Përshtatja me mjedisin dinamik është një tjetër sfidë, pasi NATO është e angazhuar në një mori operacionesh, nga ato ushtarake deri tek misionet e paqes dhe stabilizimit, si rezultat edhe nevojat logjistike ndryshojnë nga një mision në tjetrin. Pa një mbështetje amerikane, kërkesa për fleksibilitet dhe adaptim në përdorimin e resurseve dhe kapaciteteve është më e madhe. Infrastruktura dhe rrugët e komunikimit dhe lidhjet e dobëta infrastrukturore ndërmjet vendeve të ndryshme të NATO-s, mund të çojnë në vonesa dhe mungesë të shpejtësisë në mobilizimin e burimeve logjistike. Po ashtu, çështjet e sigurisë dhe ndjeshmëria ndaj sulmeve kibernetike kanë bërë që infrastruktura e komunikimit të bëhet një komponent kritik. Koordinimi më i fortë midis shteteve anëtare, pa mbështetje direkte nga SHBA-të, kërkon që NATO të investojë më shumë në bashkëpunimin ndërkombëtar dhe të krijojë struktura të centralizuara për menaxhimin e burimeve logjistike, që do të mundësojnë më shumë koordinim dhe efikasitet në operacione. NATO është një aleancë ndërkombëtare, dhe logjistika është shumë komplekse për shkak të diversitetit të shteteve anëtare, çdo vend ka kapacitete dhe infrastrukturë të ndryshme. NATO ka zhvilluar struktura të specializuara për të siguruar që të gjitha shtetet e aleancës të mund të punojnë së bashku. Megjithatë, kjo kërkon koordinim të vazhdueshëm dhe ndihmon që mjetet dhe burimet të përdoren në mënyrë efikase. Shtetet anëtare të NATO-s duhet të zhvillojnë aftësi të pavarura logjistike për të siguruar që operacionet të mos varen nga një fuqi e jashtme. Kjo mund të përfshijë investime në infrastrukturën e transportit, zhvillimin e sistemeve të menaxhimit të burimeve dhe trajnimin e personelit për të operuar në kushte të ndryshme. Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë një rol të rëndësishëm në logjistikën e NATO-s për shkak të kapaciteteve të tyre të jashtëzakonshme dhe burimeve të disponueshme. Ata janë përgjegjës për shumë nga kapacitetet e transportit si avionët dhe anijet, dhe për sigurimin e mbështetjes në terren. Për të siguruar qëndrueshmërinë operative, është e domosdoshme të krijohen mekanizma të shpejtë dhe efikasë për shpërndarjen e burimeve logjistike, veçanërisht për furnizimet kritike si karburanti, municionet dhe pajisjet shëndetësore.

Kapacitetet e transportit dhe furnizimit: NATO ka ngritur një sistem të integruar transporti dhe furnizimi për t'u siguruar që operacionet mund të zhvillohen pa ndërprerje. Ky sistem përfshin rrugë ajrore, detare dhe tokësore/hekurudhore. Megjithatë, një problem është se shumë shtete aleate janë më të kufizuara në kapacitetet e tyre logjistike, duke e bërë logjistikën e SHBA-ve një pjesë të rëndësishme. Pa mbështetje të drejtpërdrejtë nga SHBA-të, NATO duhet të forcojë masat e sigurisë në nivele të ndryshme të logjistikës. Ky përforsim mund të përfshijë avancimin e teknologjive për mbrojtjen e rrjeteve logjistike dhe krijimin e sistemeve të mbështetjes në kushte të emergjencave. Sfidat

Europa pa mbështetjen logjistike amerikane, sfidë dhe mundësi



logjistike që përballlet NATO pa mbështetje të drejtpërdrejtë nga SHBA janë të mëdha, por gjithashtu ofrojnë mundësi për përmirësim dhe rritje të pavarësisë së aleancës. Për të ruajtur qëndrueshmërinë operative, NATO do të duhet të investojë në bashkëpunim të ngushtë midis shteteve anëtare, zhvillimin e aftësive të pavarura logjistike dhe përmirësimin e infrastrukturës dhe teknologjisë. Pas një periudhe të adaptimit dhe integritit të mëtejshëm, aleanca mund të arrijë një nivel të lartë pavarësie dhe fleksibiliteti në operacionet e saj logjistike. Vlerësimi i logjistikës së NATO-s është një aspekt thelbësor i operacioneve të Aleancës, pasi logjistika siguron mbështetje të qëndrueshme dhe efikase për misionet e NATO-s, që nga operacionet ushtarake deri te ndihma humanitare dhe operacionet paqeruajtëse. Logjistika e NATO-s është shumëdimensionale dhe ka për qëllim të sigurojë furnizimin e nevojshëm, transportin, mbështetjen dhe miradministrimin e burimeve për të siguruar që ushtarët dhe materialet të jenë të gatshëm dhe në dispozicion për çdo operacion të mundshëm. NATO përbëhet nga shtete anëtare që operojnë sipas standardeve dhe sistemeve të ndryshme logjistike. Një nga sfidat më të mëdha është integrimi i këtyre sistemeve dhe siguria e ndërveprimit të tyre për të siguruar që operacionet të jenë të njëpasnjëshme dhe të shpejta. Ky bashkëpunim dhe koordinim është një nga faktorët kyç që ndihmon në suksesin e operacioneve të NATO-s. Logjistika e NATO-s kërkon një planifikim të detajuar për çdo operacion, duke përfshirë përcaktimin e burimeve të nevojshme, si dhe planifikimin për transportin dhe shpërndarjen e materialeve. Përveç kësaj, ka nevojë për një koordinim të ngushtë me vendet mikpritëse dhe organizatat ndërkombëtare të tjera, si Kombet e Bashkuara ose Bashkimi Evropian, kur operacionet janë të përbashkëta.

Përdorimi i teknologjisë moderne, si sistemet e menaxhimit të inventarit dhe logjistikës përmes mjeteve të avancuara të informacionit dhe telekomunikacionit, ka lejuar përmirësimin e efikasitetit të logjistikës në NATO.

Të dhënat e sakta dhe në kohë reale janë të domosdoshme për të siguruar që materialet të arrijnë në destinacionin e duhur pa vonesa të panevojshme. Infrastruktura logjistike e NATO-s është e përhapur dhe e adaptuar për të mbështetur një gamë të gjerë operacionesh, nga ato të shkallës së vogël deri tek operacionet ndërkombëtare të mëdha. Përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës është i domosdoshëm për të mbajtur një nivel të lartë efikasiteti dhe për të siguruar që logjistika të mund të

përballojë ngarkesat e operacioneve të ndryshme. Logjistika e NATO-s duhet të jetë e aftë të adaptohet ndaj çdo lloj terreni dhe kushte të ndryshme. Operacionet e NATO-s mund të ndodhin në kushte ekstreme, përfshirë zona të pasigurua, klimë të keqe dhe terrene të vështira. Kjo kërkon shtrirje dhe fleksibilitet në mundësinë për të siguruar mbështetje për ushtarët dhe misionet. Një aspekt tjetër i rëndësishëm është siguria e proceseve logjistike, duke përfshirë mbrojtjen e furnizimeve dhe infrastrukturës nga sulmet e mundshme ose ndërhyrjet. NATO ka zhvilluar sisteme të avancuara për të siguruar që burimet logjistike të jenë të mbrojtura dhe të menaxhuara në mënyrë efikase, duke shmangur humbjet e mundshme. Përfundimisht, logjistika e NATO-s është një element kyç për mbështetje dhe sukses të operacioneve të Aleancës dhe proceset e saj vazhdojnë të përmirësohen dhe përshtaten në përputhje me kërkesat dhe sfidat moderne të sigurisë globale. A mund të kemi qëndrueshmëri operacionale pa logjistikën amerikane?

Në teorinë e një operacioni të shkallës më të gjerë, pa mbështetje të logjistikës amerikane, do të ishim në një situatë më të vështirë për të ruajtur qëndrueshmërinë operacionale, sidomos kur bëhet fjalë për misione afatgjata dhe të largëta. Qëndrueshmëria operacionale pa logjistikën amerikane do të varej shumë nga natyra e operacioneve dhe burimet e tjera të mundshme që mund të përdoren. Në shumë raste, ku logjistika amerikane është e integruar mbetet thelbësore për operacione të mëdha ushtarake dhe civile, duke ofruar mbështetje të konsiderueshme në furnizime, transport, dhe mbikëqyrje të materialeve dhe të forcave. Megjithatë, është e mundur që një forcë ose organizatë të arrijë qëndrueshmëri operacionale pa këtë mbështetje, por kjo kërkon planifikim të kujdesshëm dhe burime të tjera. Nëse një forcë ose organizatë është në gjendje të menaxhojë burimet e veta logjistike dhe të sigurojë furnizime nga burime të tjera (p.sh., nga partnerë ndërkombëtarë, burime lokale, ose përmes rrugëve alternative të furnizimit), atëherë mund të ketë mundësi për të mbajtur operacionet në vazhdimësi. Megjithatë, kjo mund të kërkojë një nivel të lartë të specializimit në menaxhimin e logjistikës dhe një organizim të mirë të burimeve, që mund të jetë shumë më i vështirë pa mbështetje të jashtme të mëdha, siç është ajo amerikane. Disa shtete anëtare të NATO-s kanë kapacitete të mira logjistike dhe mund të ofrojnë mbështetje për operacione më të vogla ose më të fokusuar. Megjithatë, shumica e shteteve janë



të varura nga kapacitetet amerikane, si për transportin e shpejtë, ashtu edhe për mbështetje teknike. Pa logjistikën amerikane, mund të kishte vonesa dhe mungesë në furnizim me municione dhe materialet e tjera të nevojshme, veçanërisht në një shkallë të gjerë operationale. Kjo mund të dëmtonte efikasitetin e operationeve të NATO-s dhe të rrisë kostot e përfshira. Me zhvillimin e infrastrukturave dhe kapaciteteve të tjera logjistike, shtetet aleate mund të përpiqen të krijojnë burime të tjera të furnizimit dhe mbështetjes. Kjo mund të përfshijë investime në infrastrukturë më të sofistikuar të transportit, krijim sistemesh të tjera të magazinimit dhe rritjen e kapaciteteve të operationeve të brendshme. Pra logjistika amerikane është e rëndësishme për qëndrueshmërinë e operationeve të NATO-s, veçanërisht për shkallën e tyre të madhe si dhe misionet afatgjata. Si përfundim, megjithatë pa këtë mbështetje, NATO mund të operojë, por do të kishte sfida të mëdha në aspektin e efikasitetit dhe shpejtësisë së operationeve, sidomos në misionet që kërkojnë mbështetje logjistike të avancuar. Për të siguruar një qëndrueshmëri më të lartë, NATO duhet të investojë në zhvillimin e kapaciteteve të tjera logjistike dhe të rrisë më tej bashkëpunimin ndërmjet shteteve anëtare.

Natyrshëm lind pyetja: a mundet Evropa të rekrutojë trupa për të penguar Rusinë pa ndihmën e SHBA-ve? Një pyetje e cila është komplekse dhe varet nga disa faktorë politikë, ushtarakë dhe ekonomikë. Megjithatë, disa argumente mund të shqyrtohen për të analizuar mundësitë: Evropa ka disa ushtri të fuqishme, përfshirë ato të vendeve si Franca, Gjermania, dhe Mbretëria e Bashkuar (para Brexit, ishte një partner i fuqishëm në strukturat e mbrojtjes evropiane). Por, këto ushtri nuk janë gjithmonë të bashkërenduara dhe nuk kanë një nivel të barabartë kapacitetesh për të përballuar një kërcënim të madh, siç është Rusia. Një nga pengesat kryesore është se shumica e vendeve evropiane kanë shpenzime të kufizuara për mbrojtjen dhe nuk janë të gatshme të angazhohen në operatione të mëdha ushtarake pa mbështetje nga aleatët. NATO është një strukturë e rëndësishme ushtarake dhe politike e udhëhequr nga SHBA-të, por që përfshin edhe shumë shtete evropiane. Pavarësisht se Evropa mund të mobilizojë trupa, shumica e vendeve evropiane janë të angazhuara në NATO dhe varet nga rregullat e aleancës për të ndërhyrë. Nëse SHBA-ja nuk do të ishte e përfshirë, aleatët evropianë mund të kishin disa shqetësime për kapacitetin për të përballuar një kërcënim të tillë pa mbështetje të mëtijshme nga fuqia e SHBA-së, sidomos në fushën e teknologjisë dhe mbështetjes ajrore. Evropa është një kontinent me politika të ndryshme dhe interesa të ndryshme, disa shtete mund të kenë interesa të ndryshme nga të tjerat, duke e bërë të vështirë marrjen e vendimeve të shpejta dhe të koordinuara për të angazhuar trupa të mëdha. Po ashtu, shumë shtete evropiane preferojnë të shmangin përfshirjen në konflikte të mëdha dhe mund të kenë nevojë për mbështetje të SHBA-së për të justifikuar një angazhim të tillë. Një nga shqetësimet kryesore në lidhje me përfshirjen e trupave evropiane është mundësia e eskalimit të një

lufte të madhe me Rusinë. Pa mbështetje të SHBA-së, evropianët mund të ndihen të pasigurt dhe të kufizuar në mundësinë e një operationi të gjerë. Vlerësimi i logjistikës së NATO-s është një aspekt thelbësor për sigurinë dhe funksionimin e Aleancës, përveç armatimit dhe municioneve të nevojshme, pasi logjistika është ajo që mundëson mbështetje për operationet ushtarake në misionet e NATO-s. Në përfundim, ndonëse Evropa ka kapacitetin për të rekrutuar dhe angazhuar trupa, përpjekja për të penguar Rusinë pa mbështetje nga SHBA-të do të ishte shumë e vështirë dhe do të kërkonte një nivel të lartë bashkëpunimi dhe koordinimi, si dhe angazhim më të madh financiar dhe ushtarak nga vendet evropiane. Pas Luftës së Ftohtë, vendet evropiane zvogëluar sistematikisht ushtritë e tyre, me lojtarët kryesorë si Franca, që pezulluan rekrutimin dhe pësuan një rënie përkatëse në madhësinë e forcave të saj të armatosura - me 38% nga vitet 1990 deri më sot.

Vetëm Austria, Qipro, Danimarka, Estonia, Finlanda, Greqia, Norvegjia, Zvicra dhe Turqia nuk e pezulluan asnjëherë shërbimin aktiv. Një sondazh i Gallup i kryer vitin e kaluar (2024) zbuloi se vetëm 32% e qytetarëve të BE-së do të ishin të gatshëm të mbronin vendin e tyre në rast luftime. Në ekonominë kryesore të BE-së si Italia, Gjermania dhe Spanja, shifrat ishin edhe më të ulëta ku vetëm 14% e italianëve, 23% e gjermanëve dhe 29% e spanjollëve deklaruan se do të ishin të gatshëm të luftonin për vendin e tyre në rast luftime. Dr. Alexandr Burilkov, studiues në Universitetin “Leuphana” të Luxemburg deklaroi se: “Tani, gjëja më urgjente është në thelb të kesh trupa të mjaftueshme për të mbajtur vijën, jo domosdoshmërisht për të luftuar rusët, por për të dërguar një mesazh të fortë parandalues”. Ky mesazh do të thotë: “Nëse provoni atë që bë të në shkurt të vitit 2022, nuk do të ketë sukses”. Burilkov është një nga bashkautorët e një analize të përbashkët nga “Think-tank Bruegel” dhe Instituti “Kiel”, i cili vlerëson se Evropës do t’i nevojiten rreth 300,000 trupa shtesë për t’u mbrojtur, në krye të 1.47 milion personelit aktual ushtarak aktiv, përfshirë ata në Mbretërinë e Bashkuar. “Në dy vitet e fundit, rusët e kanë vendosur ekonominë dhe shoqërinë e tyre kryesisht në një bazë luftime”, tha Burilkov, duke shtuar se “kur bëhet kolektivisht, rritja e aftësive mbrojtëse nuk është një shpenzim i përcaktueshëm, veçanërisht duke marrë parasysh pasojat”. Aleatët e NATO-s aktualisht po diskutojnë se si ta bëjnë këtë, si në aspektin e pajisjeve dhe personelit ushtarak dhe rekrutimi është pjesë e debatit, tha një zyrtar i NATO-s për Euronews, duke shtuar se për të siguruar mbrojtje efektive kolektive në mjedisin aktual, nevojiten më shumë forca për të realizuar planet e mbrojtjes të aleancës. Si të gjenerohen këto forca, nëse do të përdoret sistemi i rekrutimit, forcat rezervë apo ndonjë model tjetër, është një vendim sovran kombëtar i marrë nga aleatët. Aleanca ushtarake transatlantike nuk mandaton politikën ushtarake kombëtare, por mund të luajë një rol në përcaktimin e një sinjali kërkesë dhe lehtësimin e shkëmbimeve ndërmjet aleatëve. Debatet mbi praktikën më të mira, mësimet e nxjerra dhe

rolin e mundshëm të NATO-s në adresimin e sfidave të rekrutimit dhe mbajtjes do të ngrihen në axhendën e aleancës në muajt e ardhshëm. Pas agresionit ushtarak të Rusisë kundër Ukrainës, shtetet baltike si Letonia dhe Lituania kanë zbatuar modele të ndryshme rekrutimi për të zgjeruar forcat e tyre të armatosura. Kroacia gjithashtu planifikon të rifusë shërbimin e detyrueshëm ushtarak këtë vit dhe më shumë vende mund të pasojnë, pasi shërbimet e inteligjencës paralajmërojnë për një sulm të mundshëm rus ndaj një shteti anëtar të NATO-s brenda pesë viteve dhe pasiguria rritet mbi angazhimin e Donald Trump ndaj NATO-s dhe sigurisë evropiane. Finlanda dhe Estonia kanë shërbimin e detyrueshëm ushtarak, ndërsa Danimarka, Lituania dhe Letonia përdorin një sistem rekrutimi të drejtuar nga lotaria, Norvegjia dhe Suedia e kanë shërbimin e detyrueshëm selektiv. Nuk ka një zgjidhje të vetme për të gjithë, por studiuesit e “Carnegie Europe” argumentuan në një dokument politikash të vitit 2024 se mund të nxirren mësim nga shtetet nordike dhe baltike. Këto vende kanë prezantuar stimuj të ndryshëm për ta bërë shërbimin ushtarak më tërheqës, duke përfshirë përfitime financiare dhe mundësi punësimi. Lituania, për shembull, ofron mbështetje financiare dhe logjistike për ata që i bashkohen vullnetarisht shërbimit, si dhe punësim dhe ndihmë arsimore gjatë dhe pas detyrës ushtarake. Dhe Forcat e Mbrojtjes së Estonisë punojnë me punëdhënësit privatë në programe të tilla si Rekrutimi Kibernetik i Forcave, ku ata i dërgojnë punonjësit e tyre në shërbimin kibernetik për të përmirësuar aftësitë e tyre dhe më pas i aplikojnë në punët e tyre. “Nga disa struktura ushtarake po shikohet mundësia se si të kalojnë një lloj procesi të rishqyrtimit, se cilat role duhet të jenë ushtarake dhe cilat role duhet të jenë civile, sepse natyra e luftës dhe e sigurisë kombëtare po ndryshon”, shkruan Linda Slapakova, studiuese në “RAND Europe”. Megjithatë, jo të gjithë janë dakord mbi nevojën për të rikthyer shërbimin e detyrueshëm ushtarak, një opsion ligjërësht i pamundur në disa vende dhe politikisht i pabesueshëm ose praktikisht i pamundur në të tjera. “Duke parë vetëm ushtrinë, kërkohet shumë për sa i përket infrastrukturës së trajnimit, logjistikës së nevojshme, marrjes së njerëzve përmes kontrolleve mjekësore dhe regjistrimit të njerëzve për të kryer stërvitjen dhe shërbimin e tyre”, tha Slapakova për “Euronews”, duke theksuar se kjo lloj infrastrukture nuk ekziston në shumë vende. Nëse qëllimi është vetëm përmirësimi i aftësive dhe logjistikës së forcave të armatosura, mendoj se ka shumë çështje të tjera që vendet mund të shikojnë përpara se të fillojnë të marrin në konsideratë diçka si rekrutimi i të rinjve për t’u bashkuar me shërbimin ushtarak ose civil. Për të pasur një ushtri elastike/fleksibël dhe me një mbështetje logjistike të plotë, edhe për forcat tona nuk duhet të zgjedhim vetëm fazat e fillimit të konfliktit, por duhet të vazhdojmë të edhe fazat e tjera të luftimit nëse është e nevojshme, me qëllim që të jemi në gjendje të prezantojmë një lloj sistemi që do të rriste sasinë e personelit në dispozicion, si dhe një logjistikë të fuqishme që do të rrisë fuqinë e bashkëpunimit me Aleancën.

NATO planifikon një rritje masive të objektivit të shpenzimeve të mbrojtjes

A po përpiket aleanca “t’i bëjë qejfin” Trumpit?

Vendet anëtare të NATO-s po punojnë për një plan për të rritur shpenzimet e tyre të mbrojtjes përtej objektivit aktual të aleancës mbrojtëse. Sipas raportimeve, aleanca është gati të fillojë të punojë drejt kërkesës së fundit të Donald Trump për shpenzime prej 5%.



Objektivi aktual i shpenzimeve të NATO-s

Aktualisht, shtetet anëtare të NATO-s janë zotuar prej kohësh në parim të shpenzojnë 2% të PBB-së së tyre për shpenzimet e mbrojtjes. Sipas faqes së internetit të aleancës, objektivi është një udhëzues dhe jo detyrues.

Kritikat e Trump me NATO-n

Gjatë mandatit të parë të Trump në detyrë, ai kritikoi ashpër aleatët e Uashingtonit në NATO për mos kontributin në aleancë dhe mos përmbushjen e objektivave të saj të pritura. Megjithatë, kritikat dhe kërcënimet e Trump sollën disa përfitime për NATO-n.

Falënderimi i Trump për kritikat e tij

Në vitin 2018, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s në atë kohë, Jens Stoltenberg, e falënderoi Trumpin për nxitjen e shteteve anëtare të aleancës që të rrisnin shpenzimet e tyre për mbrojtjen, duke deklaruar se përpjekjet e tij “po kishin pasur vërtet ndikim”, sipas Politico-s.

Anëtarët e NATO-s përmbushin objektivin e shpenzimeve

Në vitin 2024, 22 nga 32 shtetet anëtare të NATO-s pritej të përmbushnin ose të tejkalonin objektivin e shpenzimeve prej 2% të aleancës. Megjithatë, objektivi i dërgimit prej 2% nuk ishte më një objektiv që Trump donte që aleatët e tij ta arrinin në vitin 2025.

Një rikthim te negociatat e ashpra me NATO-n

Kthimi i Trump në presidencën e SHBA-së në vitin 2025 nënkuptonte gjithashtu se Uashingtoni do të kthehej në qëndrimin e tij të ashpër ndaj NATO-s, dhe shpejt filluan të dilnin raporte se Trump donte që shtetet anëtare të shpenzonin 5% të PBB-së së tyre për mbrojtje.

A ishte numri i Trump qesharak?

Nëse Trump e kishte seriozisht apo jo rritjen, nuk ishte e qartë. Disa argumentuan se ishte vetëm një taktikë për të fituar rritje të mëtejshme të shpenzimeve të mbrojtjes nga shtetet anëtare të NATO-s, ndërsa të tjerë pretenduan se Trump e kishte seriozisht.

NATO ka punuar për një rritje të shpenzimeve. Shtetet anëtare të NATO-s kanë punuar në heshtje prapa skenave që kur Trump tha se donte që aleanca të shpenzonte më shumë për mbrojtjen, por nëse NATO do të jetë në gjendje të përmbushë objektivat e larta të shpenzimeve të mbrojtjes të Trump apo jo, nuk është e qartë.

Vullneti politik për të parë rritjen e objektivit të shpenzimeve të NATO-s është aty. Sipas “France24”, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, më parë hodhi idenë që aleanca duhet ta çojë objektivin e saj të shpenzimeve në 3.5% deri në vitin 2032.



Një rritje prej 1.5% nga objektivi aktual

Plani i Rutte-s nuk u bë kurrë publik, por propozonte një rritje



të ndjeshme prej 1.5% të shpenzimeve dhe ai e paraqiti vizionin e tij në një letër drejtuar shteteve anëtare të NATO-s në maj sipas “Bloomberg News”, i cili citoi komentet e Kryeministrit holandez.

Barrot në një takim informal të Ministrave të Punëve të Jashtme që u zhvillua në Antalya, Turqi. Megjithatë, shtetet anëtare mund të kenë rënë dakord të shpenzojnë edhe më shumë.

Bien dakord për një objektiv shpenzimesh prej 5%

Më 25 maj, Sekretari i Shtetit i SHBA-së, Marco Rubio, sugjeroi që të gjithë anëtarët e NATO-s kishin rënë dakord të rrisnin objektivin e shpenzimeve të mbrojtjes të aleancës në 5% gjatë dekadës së ardhshme.

Shpenzimet po rriten me shpejtësi. “Ne po shkojmë drejt një samiti pas gjashtë javësh në të cilin praktikisht çdo anëtar i NATO-s do të jetë në ose mbi 2 për qind, por më e rëndësishmja, shumë prej tyre do të jenë mbi 4 për qind dhe të gjithë do të kenë rënë dakord për një qëllim për të arritur 5 për qind gjatë dekadës së ardhshme”, - tha Rubio gjatë një interviste me prezantuesin e



Sasia e duhur e shpenzimeve bazë

“Objektivi prej 3.5 është shuma e duhur për shpenzimet bazë të mbrojtjes”, u tha gazetarëve Ministri i Jashtëm Francez Jean-Noel

“Fox News”, Sean Hannity.

“Do të jetë hera e parë në historinë e NATO-s, ku ata kanë arritur objektiva dhe synime që do t’u lejojnë partnerëve të NATO-s të jenë më shumë se 50 për qind e aleancës”, - shtoi Rubio. “Ky është një moment historik nëse realizohet.”

Progresi është tërësisht falë Trumpit. Rubio shtoi se besonte që historia që NATO do të shkruante në dekadën e ardhshme, e gjitha e lidhur me kritikat fillestare të Donald Trumpit ndaj shteteve anëtare të NATO-s në vitin 2018, kur ai “i sfidoi anëtarët e aleancës të bënin një hap përpara”.

Të dhënat më të fundit të shpenzimeve nga NATO

Sipas të dhënave të fundit të raportuara nga NATO në vitin 2024 të cituara nga “Bloomberg”, Shtetet e Bashkuara përbëjnë 64% të shpenzimeve të mbrojtjes të aleancës kolektive, ndërsa Evropa dhe Kanadaja përbëjnë 36%.



Një burrë nga Arizona është bërë personi i tretë në botë që ka marrë implantin e trurit të “Neuralink” - duke e lejuar atë të ‘flasë’ përsëri me zërin e tij.

Brad Smith vuan nga ALS, një sëmundje progresive që e bën atë të paafte të lëvizë asnjë pjesë të trupit të tij, përveç syve dhe cepave të gojës.

Sëmundja e ka privuar zotin Smith nga aftësia për të folur, por implanti nga firma “Neuralink” e Elon Musk e ka lidhur trurin e tij me një kompjuter. Çipi i vogël i lejon pacientit të kontrollojë kursorin në laptopin e tij “MacBook Pro” për të shkruar.

Pastaj, inteligjenca artificiale “Grok” e Musk krijon një klon të saktë vokale, të trajnuar në regjistrime vokale të zërit të tij të vërtetë përpara se të humbiste për shkak të gjendjes, për të lexuar skenarin.

Z. Smith, pacienti i parë me ALS dhe pacienti i parë jo-verbal që mori implantin, ka postuar një video të udhëtimit të tij në X (Twitter), ku shprehet:

“Unë mund ta kontrolloj kompjuterin me telepati - jeta është e mirë!”.

Ai shtoi: “‘Neuralink’ nuk i lexon mendimet ose fjalët e mia më të thella për të cilat mendoj”.

ALS – që do të thotë skleroza laterale amiotrofike – është një sëmundje progresive që prek qelizat nervore në tru dhe palcë kurrizore.

Siç shpjegon pacienti në videon e tij, ALS shkakton humbje të kontrollit të muskujve dhe i ka marrë aftësinë për të folur, por nuk ndikon në mendje.

“Unë kam ALS, një sëmundje vërtet të çuditshme që vret neuronet motorike që kontrollojnë muskujt e mi, por nuk ndikon në mendjen time”, - tha ai.

“Përvoja ime ka qenë mjaft interesante, duke filluar me një dëmtim në shpatull që nuk do të shërohej dhe duke përfunduar me gjendjen time aktuale.

“Nuk mund të lëviz asgjë përveç syve dhe jam plotësisht i varur nga një ventilator për të më mbajtur gjallë dhe për të marrë frymë”.

Çipi i “Neuralink” vendoset në një rajon të trurit që kontrollon qëllimin për të lëvizur nga një kirurg robotik “i ngjashëm me makinën e qepjes”.

Roboti heq një pjesë të vogël të kafkës, lidh elektodat në formë fijesh me zona të caktuara të trurit, qep vrimën dhe e vetmja gjë që mbetet e dukshme është një shenjë e lënë nga prerja.

“Fijet vendosen nga një robot vetëm disa milimetra në trurin tim, duke shmangur enët e gjakut, kështu që nuk ka pothuajse asnjë gjakderdhje”, - shtoi zoti Smith.

Çfarë është “Neuralink”?

“Neuralink” është një kompani neuroteknologjie e themeluar nga Elon Musk në vitin 2016. Kompania është e njohur për implantin e saj të trurit, i njohur si ndërfaqja tru-kompjuter (BCI), i cili interpreton aktivitetin nervor në tru në mënyrë që një person të mund të përdorë një smartphone ose të kontrollojë një kursor kompjuteri vetëm duke menduar.

Me madhësinë e afërsisht pesë monedhave të grumbulluara, BCI ka fije të vogla që lexojnë aktivitetin nga neuronet (qelizat nervore) në tru.

Tre persona me implantin janë në gjendje të kontrollojnë një maus kompjuteri duke përdorur mendimet e tyre.

“Implanti lidhet me kompjuterin nëpërmjet bluetooth-it dhe kompjuteri bën shumë përpunime”.

Implanti kap shkrepjet e neuroneve - sinjale elektrike të lëshuara nga qelizat nervore të trurit - çdo 15 milisekonda, duke gjeneruar ‘një sasi të madhe’ të dhënash.

“AI-ja përpunon këto të dhëna në një MacBook Pro të lidhur për të deshifruar lëvizjet e mia të synuara në kohë reale për të lëvizur kursorin në ekran”, - shtoi pacienti.

Është detyra e kompjuterit të vendosë se çfarë është e



Pacienti i tretë me implantin “Neuralink” rifiton të folurin



rëndësishme - gjetja e sinjalit përkatës dhe ‘injoinimi i zhurmës’.

Përpara “Neuralink”, Z. Smith përdorte një kompjuter kontrolli të shikimit për të gjithë komunikimin - por ai funksiononte më mirë në dhoma të errëta, duke ndikuar në aftësinë e tij për të dalë jashtë.

“‘Neuralink’ më lejon të dal jashtë dhe të injoroj ndryshimet e ndriçimit”, - tha pacienti.

Sipas “Neuralink”, në të ardhmen fijet e implantit do të implantohen më thellë në tru dhe në thellësi të ndryshme, me saktësi të shtuar për të maksimizuar efektivitetin.

Musk, i cili themeloi “Neuralink” në vitin 2016 me një ekip prej shtatë shkencëtarësh dhe inxhinierësh, premtoi se “do të përmirësohet vetëm nga këtu e tutje”.

Musk parashikon implantet “Neuralink” që mund t’u rikthejnë shikimin të verbërve, t’u japin njerëzve shikim infra të kuq ose ultravjollcë ose t’i lejojnë ata të ndajnë koncepte me të tjerët në mënyrë telepatike.

“Ne duam t’u japim njerëzve superfuqi”, - tha ai.

Në janar, kompania e neuroteknologjisë instaloi implantin e saj të parë të trurit te tetraplegjiku Noland Arbaugh me bazë në Arizona - një operacion që Musk e cilësoi si një sukses.

Z. Arbaugh ishte në gjendje të kontrollonte një maus kompjuteri, duke përdorur mendimet e tyre dhe të garonte me njerkun e tij në Mario Kart të “Nintendo-s”, si dhe të merrte mësim japoneze dhe frënge, duke kontrolluar një kursor të ekranit të kompjuterit me trurin e tij.

Megjithatë, Z. Arbaugh - i cili mbeti i paralizuar nga supet poshtë nga një aksident zhytjeje tetë vjet më parë - pësoi një gjendje kërcënuese për jetën gjatë operacionit.

Në gusht të vitit të kaluar, Musk zbuloi se një pacient i dytë, një viktimë e dëmtimit të palcës kurrizore i quajtur Alex, kishte marrë çipin.

“Synchron Inc.”, një rival i “Neuralink”, po teston gjithashtu një implant që mund të ndihmojë njerëzit me dëmtime motorike, në një kompjuter.

“Neuralink” ka një histori kontraverse të testimit në kafshë

“Neuralink”, e cila u vlerësua në rreth 5 miliardë dollarë, është përballur me thirrje të përsëritura për shqyrtim në lidhje me protokollet e saj të sigurisë dhe testimin në kafshë.

Ka kaluar vitet e fundit duke testuar implantin në kafshë, gjë që ka dhënë rezultate të përziera. Në një prezantim të vitit 2020, Musk zbuloi çipin “Neuralink” për publikun për herë të parë, me një demonstrim në një derr të quajtur Gertrude.

Një derr tjetër i përfshirë në demonstrim dikur kishte pasur një implant, por më pas e kishin hequr dhe po jetonte një “jetë të shëndetshme”.

Vitin pasardhës, Musk bëri një demonstrim tjetër, i cili përfshinte një majmun makake me një çip truri që luante një lojë kompjuterike duke menduar vetëm.



Megjithatë, në shkurt 2022, “Neuralink” konfirmoi se majmunët kishin vdekur gjatë testeve të tij, megjithëse mohoi çdo abuzim me kafshët.

Kjo e fundit ishte në përgjigje të pretendimeve të bëra nga një organizatë jofitimprurëse, Komiteti i Mjekëve për Mjekësi të Përgjegjshme (PCRM), në një ankesë me Departamentin e Bujqësisë të SHBA-së.

Shqetësimet e ngritura nga PCRM në ankesë përfshinin një shembull të një majmuni që i mungonin gishtat e duarve dhe të këmbëve që mund të ishin humbur për shkak të ‘vetëgjymtimit’.

Një rast tjetër është ai i një majmuni me vrima të shpuara në kafkën e tij për t’i implantuar elektroda në tru, dhe një e treta e njërit prej tyre vuante nga hemorragjia në tru.

Shumica e majmunëve duhej të eutanizoheshin, ose të vdisnin si rezultat i procedurave, sipas ankesës.

Jeremy Beckham, nga PCRM, i tha “New York Post” se “pothuajse çdo majmun që kishte implante të vendosura në kokë vuajti nga efekte mjaft dobësuese shëndetësore”.

Përveç pretendimeve për mizori ndaj kafshëve, ekspertët paralajmërojnë se mund të ketë probleme me privatësinë me implantet e trurit.

Dr. Susan Schneider, drejtoresha themeluese e Qendrës së re për Mendjen e së Ardhmes, i tha “Daily Mail” në prill 2021: “Nëse përdorimi i përhapur na lidh me “cloud”-in, jo si terapi, dhe bashkon njerëzit me inteligjencën artificiale, modeli ekonomik do të jetë shitja e të dhënave tona”.



Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Në kuadrin e 84-vjetorit të atentatit që Vasil Laçi kreu ndaj Viktor Emanuelit III, më 17 maj 1941, që ishte sinjal kushtrimi të luftës, antifashizmit italian në Shqipëri.

Plumba mbi fashizmin, fillimi i kryengritjes mbarë popullore. Pala shqiptare dhe italiane synuan ta minimizonin ngjarjen e 17 majit të vitit 1941. Po nuk mundën. Kjo ngjarje as u shua as u harrua, pasi pushtimit të 7 prillit 1939 i kishte ardhur “ora e kundërpërgjigjes” mbarë popullore. As vizita njëjavore e Viktor Emanuelit nuk rezultoi sukses në “rrugëtimin miqësor”. Pushtimi ishte ngjarja që kërkonte shpagim, pasi italianët kishin “harruar”, vitin 1920, kur 89 çeta luftëtarësh shqiptarë, hodhën në det një perandori 40 milionëshe. Fashizmi erdhi në botë si një formë e ultra-nacionalizmit autoritar radikal të krahut të djathtë, i karakterizuar nga pushteti diktatorial,

Fashistët u frymëzuan nga burime të lashta si spartanët, duke u nisur nga pastërtia racore dhe elitarizmi. Fashizmi e gjente frymëzimin dhe tek vijueshmëria ideologjike e Romës, veçanërisht Perandorisë Romake. Edhe këndvështrimi i Hegelit mbi autoritetin absolut të shtetit ndikoi në një farë mënyre dhe në të menduarit fashist. Nga ana tjetër “revolucion i francez” pati ndikim që i bënte fashistët, që të luftonin idetë e liberalizmit, demokracisë liberale e barazinë racore. Kultura aristokrate “e lartë dhe fisnike” ariane, në krahasim me një kulturë semite “parazitare”, ishte thelbi i pikëpamjeve racore të nazizmit. Të gjitha këto koncepte gjetën strehë dhe mbështetje tek Hitleri, Duçja dhe Perandori japonez, që më 7.7.1937 kishte pushtuar Kinën dhe synonte të shtrinte pushtimet në Azinë lindore e jugore. Boshti fashist Berlin – Romë – Tokio i arritur në vitin 1936, synonte ta vendoste nën thundër mbarë planetin.

Fuqitë e Boshtit, të njohura si “Boshti Roma-Berlin-Tokio”, u njohën me një nofkë që i përkonte një emri italian “Roberto”. Gjithçka u motivua nga inicialet e: “RO-ma”, “BER-lin” dhe “TO-kio”. Hapi i parë ishte traktati i nënshkruar nga Gjermania dhe Italia në tetor 1936. Benito Mussolini deklaroi, më 1 nëntor 1936, se të gjitha vendet e tjera evropiane nga ajo kohë do të rrotulloheshin në boshtin Romë-Berlin, duke krijuar kështu termin “Boshti”. Më 2 nëntor 1936, diktatori italian Benitto Musolini shpall Boshtin Romë, Berlin, duke krijuar aleancën e Fuqive të Boshtit. Termi “bosht” besohet të jetë përdorur fillimisht nga kryeministri fashist i Hungarisë, Gyula Gombos, i cili përkrahte idenë e një aleance Gjermani – Hungari – Itali. Ai veproi edhe si ndërmjetës mes Gjermanisë dhe Italisë për të arritur një aleancë të tillë. Por Gombos vdiq papritur në vitin 1936, dhe ardhja e Kalman Daranyit, pasardhës jo-fashist në postin e kryeministrit, i dha fund përpjekjeve të Budapestit për krijimin e një boshti 3-palësh. Hapi i dytë pothuajse i njëkohshëm ishte nënshkrimi i nëntorit 1936 i Paktit Anti-Comintern, një traktat antikomunist midis Gjermanisë dhe Japonisë. Italia u bashkua me Paktin në vitin 1937. Boshti Romë - Berlini u bë një aleancë ushtarake në vitin 1939, nën të ashtuquajturën “Pakti i Çelikut”, me Paktin Trepalësh të vitit 1940, që çoi në integrimin e qëllimeve ushtarake të Gjermanisë, Italisë dhe Japonisë. Fillimi i LIIB dhe vazhdimi i saj për 5 vite rresht shkaktoi tragjedinë më të madhe të shumë kohërave që nga fillimi i njerëzimit, luftë që përfshiu mbi 100 milionë njerëz me mbi 30 shtete, ku u vranë miliona njerëz (70-85 milionë njerëz, shumica nga BS), përfshi nga gjenocidi, masakrat, Holokausti, bombardimet strategjike, uria, Përdorimi i armëve bërthamore etj.

Shqipëria ishte preha e parë e fashizmit italian, por 1939-1941 zjarri i përballjes me fashizmin sa vinte e rritej. Gjeneral Alfredo Guzzoni erdhi në portet shqiptare me 22 mijë burra nën uniformë atë ditë të zezë prilli. Po me kaq burra edhe ishte larguar i turpëruar një tjetër gjeneral italian Settimo Piacentini më 3 shtatorin e vitit 1920. Ndërkohë që këtë radhë vinin si fashistë me “ideale të ish-Romës perandorake”. Nuk e dinin se shqiptarët dinë të zgjohen në momentin e duhur edhe kur nuk kanë shtet edhe kur i tradhtoi kryetari i shtetit. Një pikë kulmore ishte padyshim 17 maji 1941, kur plumbat u derdhën mbi kokën e perandorit dhe jo vetëm edhe mbi shoqëruetin e parë krye-bashkëpunëtorin dhe “kryeministrin” Shefqet Vërlaci. Djaloshi 19-vjeçar Vasil Laçi qëllloi makinën, e cila transportonte Viktor Emanuelin III, ai edhe Mbret i pagëzuar i Shqipërisë, pas dorëzimit të Kurorës së Skënderbeut, më 12 prill të 1939. Ngjarja e ndodhur ditën e shtatë të vizitës në Shqipëri dhe që po largohej në drejtim të aeroportit të Laprakës, në rrugën e Durrësit ishte vetë zjarri i rinisë antifashiste që kishte në gji dhe sinjali i fuqishëm i fillimit të një lufte mbarë popullore, që u dha hapur dhe në mënyrë demonstrative nga tyta e revolverit të djaloshit antifashist të vendosur nga fshati Piqeras i bregdetit jonin pranë Sarandës.

PLUMBAT E VASIL LAÇIT QË TRONDITËN FASHIZMIN



Kush ishte Vasil Laçi, hero dhe dëshmor i lirisë së shqiptarëve?

Vasil Laçi, ishte lindur më 19 shtatorin e vitit 1920, në fshatin Piqeras të Bregdetit pranë Sarandës, në një familje me rrënjë atdhetare e patriotike një fshat me dymbëdhjetë yje të pashuar, dëshmorë të Atdheut të rënë gjatë LANÇ-it. Piqerasi ka dy heronj të popullit Vasil Laçi dhe Mitro Xhani. Vasil Laçi arsimimin fillor e kreu në vendlindjen e vet, ndërkohë që kishte dëshirë për të vazhduar shkollën e lartë që nuk mund të përmbushej për pamundësi financiare. Gjendja ekonomike e familjes Laçi, e detyroi Vasil Laçin të fillonte punë si punëtor krahu në portin e Sarandës, e cila për moshën e vogël të djaloshit, 14 vjeçar, ishte e rëndë, por me një shpërbllim të vogël qesharak. Por për adoleshentin piqerasiot ishte hapi i parë në jetë, duke u përballur me jetën e vështirësitë e panumërta. Punën e krahut Vasili e vazhdoi për vite me radhë nga Saranda në portin e Durrësit e më tej edhe në Tiranë, duke u përballur me gjithfarë punësh. Në portin e Durrësit ai punoi si hamall bashkë edhe me Mitro Xhanin, fshatarin e tij, i cili e ndihmoi për të shkuar në Tiranë me shpresë për të gjetur ndonjë punë, por edhe për të mundësuar lidhjen e tij me njësitet antifashiste. Në Tiranë Vasili Laçi punoi në Hotel “Berati”, duke mbajtur lidhje me farefisn, me Kol Laçin, kushëriri i tij, anëtar i Grupit Komunist të Korçës, por dhe me shumë shokë e miq të tjerë nga e gjithë Shqipëria. Vasil Laçi hotelin e kishte kthyer në një strehë për të ndjekurit nga fashizmi, për punëtorë të papunë, ushtarë të dezertuar nga lufta italo-greke e viteve 1940-1941 dhe të gjithë ata që realisht e urrenin fashizmin. Ai fliste dhe argumentonte me guxim për pakënaqësitë që kishte shkaktuar fashizmi italian për mohimin e lirive, grabitjen e pasurive, rritjen e varfërisë ekonomike, por edhe për shtypësit e shfrytëzuesit vendas. Në Hotel Berati, Vasil Laçi u lidh me Vasil Shanton, shok dhe mik i ngushtë i Qemal Stafës. Vasili në aktivitetin revolucionar, bërjen e atentatit, më 17 maj 1941, kundër Viktor Emanuelit III, u lidh me Stilo Mekshin nga Shënvvasili i Sarandës. Stilo i bleu Vasilit revolverin “Beret” me 5 fishekë, 50 franga ari me paratë e veta tek një ushtar italian i quajtur Umberto. Vasili gjatë përgatitjes së atentatit e ruante të fshehtë revolen para aksionit. Atë e kishte fshehur në dyshtet e dhomës, e vajtiste, e pastronte në vijimësi, shpjegonte bashkëpunëtori i tij i ngushtë Stilo Mekshi. Vasili i thoshte Stilos: “Beretin e duam që të ruajmë kokën dhe për neve do të vijë një ditë e mirë që plumbat t’i derdhim mbi fashizmin”. Stilo tregonte: “U dëgjua një altoparant me thirrjen që nesër vjen mbreti në Tiranë. Dil e bëj sehir ti, - tha Vasili, - sepse unë do të dal ta përcjell kur të largohet”. Dhe vërtet e përcolli me 5 plumba”. Ditën e ballafaqimit në gjyq,

Vasili u shpreh: “Mos merrni njeri në qafë! Unë e kreu vetë atentatin, pa u ndikuar nga askush tjetër”. Vasil Laçi u gjykua nga gjykata ushtarake e shtetit fashist italian. Trupi gjykues drejtohej nga gjeneral Feruci, prokuror i akuzës ishte gjeneralmajor Umberto Meragini. Ky gjyq u bë me dekret të posaçëm mbretëror. Vendimi ishte i formës së prerë, nuk u lejua të bëhej apel. Më 26 maj 1941, Vasil Laçi u dënua me vdekje, varje në litar. Ai u ekzekutua më 27 maj 1941, ora 5.40 në burgun e Tiranës. Pyetjes së trupit gjykues për dëshirën e tij të fundit, Vasili iu përgjigj: “Dua një krehër për të krehur flokët!”. Gjatë ekzekutimit me varje Vasili nuk pranoi t’i largonin arkën e sigurisë së ekzekutuesit, por e shtyu vetë me këmbë. Nga të dhënat dokumentare, “Dënimi me vdekje u ekzekutua me varje në litar dhe sipas konstatimit të mjekut, atij i doli shpirti 19 minuta pas varjes”. Më 17 maj 1941, kur mbreti italian po largohej nga vizita njëjavore në Shqipëri, Vasili qëllloi mbi të me 5 plumba, por nuk e vrau dot, por nuk u vra vetëm fizikisht, por moralisht u diskreditua dhe e mori mesazhin e antifashizmit nga shqiptarët. Atentati i Vasil Laçit mbi Perandorin e Italisë fashiste ishte një urrejtje kulmore për pushtuesit fashistë, ishte akt frymëzimi për brezat, pasi pesë plumbat mbi mbretin fashist ishin thirrje për kryengritje të armatosur si i vetmi mjet i fitores së lirisë dhe të drejtave kombëtare. Ishin akt trimërie, vetëmohimi për interesat e përgjithshme që Vasil Laçi i dinte mirë pasojat, por ishte i ndërgjegjshëm për misionin e lartë që kreu mbi pushtuesit fashistë. Krismat e revolverit gjëmuar në Tiranë, por u dëgjuan në të gjithë Shqipërinë. Jehona e tyre u përhap në të si rrufe, pasi ato ishin krisma simbol trimërie, burrërie, vendosmërie për t’i dalë zot Atdheut në kohët më të rrezikshme. Trimëria e Vasil Laçit nuk u shkreh vetëm në atentatin mbi mbretin, por edhe me qëndrimin e tij plotësisht të heshtur që mbajti gjatë hetimit. Ai nuk kallëzoi asnjë njeri dhe e pranoi se e kishte kryer vetë atentatin nga urrejtja për pushtuesit fashistë. Torturat e shumta nuk mundën, nuk e thyen, nuk e ligështuan, ai nuk kërkoi falje as përpara njeriut të Zotit, nuk u përkul për aktin e kryer, për aktin madhor që ishte në nderin e Atdheut, në funksion të lirisë së Shqipërisë.

Për aktin që ka kryer Kuvendi Popullor e ka dekoruar Vasil Laçin me titullin më të lartë “Hero i Popullit”, është dëshmor i Atdheut si dhe ka merituar vlerësimin nga Presidenti i Shqipërisë për Vasil Laçin (pas vdekjes) me “Dekoratën e Flamurit Kombëtar” me motivacionin e poshtëshënuar: “Atdhetarit antifashist që me aktin e tij heroik dhe vetëflijues i tregoi të gjithë shqiptarëve e veçanërisht rinisë se rruga drejt lirisë dhe çlirimit të atdheut kalonte vetëm përmes fuqizimit të rezistencës së paepur ndaj pushtuesve dhe gatisshmërisë edhe për sakrificën më sublime. Atentati i tij kundër uzurpatorit të fronit të Shqipërisë ishte demonstrimi më kuptimplotë patriotik dhe atdhetar kundër pushtimit fashist dhe dhunimit të sovranitetit shtetëror dhe kombëtar” (me nr. Dekreti: 11407, datë 31.12.2019). Ndërkohë që në shtypin shqiptar ka me dhjetëra artikuj që përjetësojnë heroizmin, si dhe akti i tij heroik dhe i pa zëvendësueshëm, është përjetësuar edhe në filmin “Plumba Perandorit”, në vitin 1980, nga Kinostudioja “Shqipëria e Re”. Plumbat e Vasil Laçit që derdhi mbi Perandorin, ishin plumbat e urrejtjes shqiptare ndaj fashizmit, 84 vite më parë. Në këto më shumë se tetë dekada Shqipëria dhe popujt e botës përjetuan eksperiencën nga më të hidhurat pasi ekstremizmi politik botëror ka kaluar shpesh në çmendurira me udhëheqës anormalë që fusin popujt në luftë dhe luftën e kanë obsesion kokat e nxehta të politikës botërore. Ky mësim i hidhur i historisë shpresohet të mos përsëritet, duke kujtuar të rënë dhe të parandalohet çdo tragjedi, urrejtje dhe konfliktet që të çojnë në të ardhme të pasigurt. Nderimi i heronjeve, dëshmorëve është nderim dhe respekt për historinë, nderim i vlerave antifashiste, që forcat e errëta të mos duken as në asnjë horizont apo projektion të zhvillimit të popujve.



Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Kongresi i Përmetit i zhvilloi punimet e tij në kulmin e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare nga data 24-28 maj 1944. Konferenca e Pezës, që ishte ngjarje e parë kulmore e luftës dhe Kongresi i Përmetit përbëjnë dy ngjarjet më madhore të popullit shqiptar që përcaktuan fatin e luftës. Konferenca e Pezës i dha përmasa luftës, ndërsa Kongresi i Përmetit i dha çlirimin e vendit, më 29 Nëntor 1944. Kongresi u thirr në një moment historik, kur Luftës së Dytë Botërore po i vinte fundi. Fuqitë e Mëdha që kryesonin Koalicionin Antifashist Botëror po bënin hesape për përfitime të luftës, me ndryshimet që po pësonte Europa e pas luftës. Me përfundimin e luftës erdhën Konferencat e Jaltës dhe e Paqes në Paris, në vitin 1946. Këto konferenca vendosën hartën politike të Europës. Të gjithë bënë llogaritë, aleatë e koalicion, kishte nisur një luftë politike e diplomatike, ku dhe Shqipëria ishte përfshirë nga qarqe të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Kishte nisur loja për ndryshime politike edhe në zhvillimin e ngjarjeve në Shqipëri. Përpjekje bëheshin për të sabotuar luftën e për mos lejuar fitoren e revolucionit dhe kalimin e pushtetit në duart e komunistëve. Lufta nga qarqe të caktuara bëhej për të krijuar qeveri kukull, në dëm të Lëvizjes Antifashiste. Kundër Shqipërisë dhe luftëtarëve të lirisë u përfshinë fqinjët, qarqe të caktuara, si dhe aleatë të saj në Luftën e Dytë Botërore.

Lëvizja Antifashiste Nacionalçlirimtare u tregua e përgatitur dhe punonte që të mos zihej në befasi. Misionin historik e realizoi mjaft qartë Kongresi i Përmetit. Ky kongres mori vendime historike, të cilat sollën çlirimin e vendit dhe asgjësimin e synimeve dhe të planeve reaksionare të brendshme dhe të jashtme. Kongresi afirmoi kalimin e pushtetit në duart e forcave antifashiste të cilat ishin masivizuar shumë në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare. Mbajtja e Kongresit shkaktoi turbullime në forcat kundërshtarë, të cilat kishin kohë që bashkëpunonin me nazi-fashistët. Vendimet e Kongresit shuan shpresat dhe mundësitë e tyre për realizimin e synimeve që kishin. Peza dhe Përmeti i bëjnë nder dhe sot Shqipërisë. Përmeti ishte kongresi i Frontit të Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare. Në përbërje dhe në pjesëmarrjen e delegatëve të Kongresit të Përmetit shumica ishin patriotë dhe atdhetarë. Delegatët e Kongresit të Përmetit ishin nga i gjithë vendi, ata përfaqësonin të gjitha forcat shoqërore pjesëmarrëse në luftë. Në këtë kongres pati përfaqësues të këshillave nacionalçlirimtare, të njësive partizane, nga terreni e ushtria, veprimtarë të organizatave të Frontit, të Rinisë Antifashiste, të Gruas etj. Delegatët në sallën e Kongresit ishin luftëtarë të vijës së parë, patriotë e atdhetarë, luftëtarë nga i gjithë vendi, pavarësisht besimit fetar e bindjeve dhe përbërjes politike. Delegatët, me përgjegjësinë që iu kërkonte koha, u gjendën në Frontin Nacionalçlirimtar dhe luftuan kundër pushtuesit për çlirimin e vendit. Në organet që zgjodhi Kongresi, ishte një përfaqësi popullore. Në Këshillin Antifashist Nacionalçlirimtar, në Kryesi, si dhe në Komitetin Antifashist, organe kryesore të shtetit të ri shqiptar, ishin komunistët Sejfulla Malëshova, Enver Hoxha, Ymer Dhishnica, Hysni Kapo, Gogo Nushi, etj., patriotët Myslim Peza, Spiro Moisiu, Omer Nishani, Haxhi Lleshi, Gaqo Tashko, Shefqet Peçi, Jaho Gjoliku, Islam Radovicka, Zyliftar Veleshnja, P. Harito, M. Konomi, S. Shaplllo, S. Shpuza, E. Barhani, E. Dishnica, Sh. Arra etj., intelektualë me prirje antikomuniste Shefqet Bejo, Gjergj Kokoshi, Riza Dani, etj.

Vendimet e Kongresit nuk ishin parime komuniste

Vendimet që u morën në Kongresin e Përmet nuk ishin parime komuniste, por vendime të marra me kohë dhe në vende të Lindjes e të Perëndimit etj. Vendimet ishin: të ndërtohet Shqipëria e re demokratike e popullore sipas vullnetit të popullit,

PEZA DHE PËRMETI I BËJNË NDER SHQIPËRISË



që shprehej solemnisht në Këshillin e Përgjithshëm Antifashist, t'i ndalohej ish-mbretit Zog kthimi në Shqipëri dhe të mos njihet asnjë qeveri që mund të formohej brenda ose jashtë vendit kundër vullnetit të popullit dhe të vazhdohej më me ashpërsi lufta kundër pushtuesve gjermanë dhe tradhtarëve, deri në shkatërrimin e tyre të plotë dhe vendosjen e pushtetit demokratik-popullor në të gjithë vendin. Këto vendime zbërtheheshin si ripohimi i Pavarësisë së Atdheut, vendosjen e regjimit demokratik, ku forma e të cilit do të vendosej pas çlirimit me vullnetin e popullit, organizimi i zgjedhjeve të lira, ripohimi i aleancës me aleatët e mëdhenj pa dallim, ndalimi i kthimit të Zogut në Shqipëri, si dhe anulimi i marrëveshjeve të lidhura prej tij në dëm të pavarësisë së vendit, etj.

Këshilli i Përgjithshëm vendosi për rishikimin dhe prishjen e gjithë marrëveshjeve politike dhe ekonomike që binin në kundërshtim me interesat e popullit dhe të kombit shqiptar, shndërrimin e Ushtrisë partizane në ushtri të rregullt, me një udhëheqje të njësuar dhe me një komandë të përgjithshme, si dhe dhënien e gradave ushtarake, vendimin për kalimin e Ushtrisë në mësymje të përgjithshme për çlirimin e plotë të trojeve shqiptare. Kongresi miratoi veprimtarinë e përgjithshme të udhëheqjes së Luftës dhe udhëzimet e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare shqiptare. Këto ishin dhe ligjet e para të pushtetit demokratik popullor. Në marrjen e këtyre vendimeve ishin dhe përfaqësues të Koalicionit Antifashist, amerikanë dhe anglezë, të cilët i duartrokitën dhe i miratuan vendimet. Në sallën e kongresit krahas portreteve të Skënderbeut dhe rilindësve tanë të mëdhenj, ishin dhe flamurë të SHBA-Angli-BS.

Çështja e Kosovës dhe qëndrimi ndaj Zogut

Kundërshtarët e Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare, si dje në luftë dhe pasardhësit e tyre janë përpjekur të mohojnë Kongresin në çështjen e Kosovës dhe në qëndrimin e mbajtur ndaj mbretit Zog. Omer Nishani, Kryetari i Këshillit Antifashist,

në fjalën e tij historike ka theksuar se “kosovarët nëse duan të fitojnë të drejtën e vetëvendosjes së tyre në bazë të Kartës së Atlantikut duhet të hyjnë në radhët e Frontit Nacionalçlirimtar dhe të luftojnë pushtuesin. Vetëm në këtë udhë Kosova pas luftës do të ketë të drejtë të vendosë mbi fatin e saj gjer në shkëputje”. Qëndrim i Kongresit ishte në përputhje me Kartën e Atlantikut e me parimin e vetëvendosjes, të cilën e kishin pranuar të gjitha vendet e Koalicionit Antifashist. Ndërsa për mbretin Zog, i cili braktisi vendin, duke e lënë popullin në mëshirën e fatit, pa armë e pa drejtim dhe që u vështirësua shumë organizimi i qëndresës antifashiste. Ndaj dhe ndryshe nga mbretërit e tjerë të Ballkanit, Zogu nuk u njoh dhe nuk u pranua nga Fuqitë Aleate. Kongresi e ndaloi Zogut të kthehej në vend dhe fatin e monarkisë e të formës së shtetit shqiptar, do e vendoste populli shqiptar pas çlirimit.

Kongresi i Përmetit, një faqe e lavdishme e historisë

Vendimet e Kongresit të Përmetit në çështjen e formës së shtetit shqiptar, ecën në rrugën e zgjidhjes me organizimin e zgjedhjeve për Asamblenë Kushtetuese më 2 dhjetor 1945. Këto ishin zgjedhjet e para të organizuara pas çlirimit të vendit dhe u zhvilluan në praninë e vëzhguesve të shumtë ndërkombëtare dhe të presionit të shteteve demokratike që kërkonin respektimin e normave demokratike. Në zgjedhje mori pjesë 90 për qind e votuesve dhe mbi 93 për qind e tyre i dhanë votat për kandidatët e Frontit. Rezultati u pranua e nuk u kontestua as nga brenda dhe as nga vendet aleate. Në këto kushte Asambleja Kushtetuese, e dalë nga këto zgjedhje, kishte legjitimitetin e plotë për të vendosur në çështjen e rëndësishme siç ishte forma e regjimit. Duke shprehur vullnetin e popullit, më 11 janar 1946, Asambleja Kushtetuese shpalli Shqipërinë Republikë Popullore.

Kongresi i Përmetit përbën faqe të lavdishme të historisë së LANÇ-it dhe të historisë së popullit shqiptar. Kongresi i Përmetit dhe vendimet e tij historike janë aktuale dhe sot.



DEFENDER

EUROPE 2025